

## INTERVISTË ME GARENTINA KRAJËN

Prishtinë | Data: 3 dhe 17 maj, 2017

Kohëzgjatja: 158 minuta

Të pranishëm:

1. Garentina Kraja (E intervistuar)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Garentina Kraja:** Unë jom Garentina Kraja. Për momentin ligjëruse në Universitetin Amerikan të Kosovës. Përndryshe ish-gazetare edhe ish-presiden... jo, ish-këshilltare e Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga.

**Aurela Kadriu:** Garentina, a mundeni me na tregu për kujtimet e juja t'hershme të fëminisë, për familjen? Çfarë familje keni qenë ju? Qysh ka qenë jeta juj?

**Garentina Kraja:** Domethonë unë jom fëmija ma i madh në familje t'pesë anëtarëve, pesë fëmijë jemi. Babën shkrimtar, gazetar n'fakt. Ka fillu profesionin e tij si gazetar në vitet e '70-ta, n'fund t'viteve të '70-ta, realisht prej kur ka fillu me studiu në Universitetin e Prishtinës. Baba vjen prej fshatit Krajë, në Mal të Zi, realisht regjionit Krajë fshati Kshtenjë. Ai ka ardhë në Kosovë. Domethonë e ka një rrëfim ma t'veçantë. Familja e tij, vllaznit e tij kanë zgjedhur, zgjedhë rrugën e imigrimit për Amerikë, ndërkohë që baba ka ardhë në Prishtinë edhe ka fillu me studiu Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe në Universitetin e Prishtinës, që është hapë në vitin 1974 atëherë. Domethonë ndër gjeneratat e para të, të Universitetit të Prishtinës.

Aty është taku me nanën, e cila vjen nga Istogu, nga një fshat, fshati Cërrc i Istogut. Ajo osht' besoj, n'fakt është femra e parë n'familje t'saj që ka zhvillu studimet, studimet e larta. Edhe nana njejtë sikur baba ka studiu Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe në Universitet të Prishtinës.

Thashë fëmija ma i madh, që realisht nuk ka pasë ndonji... te ne ma shumë... domethonë ka qenë të njejtën kohë kom qenë fëmija ndoshta ma i lazdrum n'shpi, po t'njejtën kohë edhe kom qenë fëmija me mas shumti obligime tu qenë fëmija ma i madh edhe tu u mundu prej meje me kriju shembull për fëmijtë, për motrat edhe vëllaun tim. Domethanë, motra Arzana, vëllau Vegimi, motra tjetër Vesa edhe Gresa osht' motra jonë ma e vogël. Unë edhe Gresa i kemi dikun dallim dymbëdhjetë vjet, që osht' për mu shumë mirë tash se Gresa m'ndihmon me qenë e lidhur me aktualitetin e gjeneratës re në nifarë mënyre, me pa qysh po mendojnë, qysh po funksionojnë. Sepse me tjerët pak a shumë jeni, vitet nuk jonë edhe aq, dallimet brenda viteve t'gjeneratës, nuk jonë aq t'mdhaja.

Shkollën... tashti t'filloj prej memorjeve t'mija t'para, kujtimeve t'mija t'para domethonë i kisha veçu

shkollën. N'skollë kom shku në, atëherë, “Josip Broz Tito”<sup>1</sup> gjatë kohës sa kom qenë, “Jsip Broz Tito” në Breg të Diellit. Ne e kemi ndrru banesën. Kemi qenë tu jetu në Breg të Diellit, kemi zbrit në Ulpianë, por për shkak të, që jom ndi shumë e afër me klasën time edhe me mësuesin, nuk e kom ndrru shkollën, tu ju qitë shumë telashe n'fakt prindve t'mi. Po, ndoshta pse kom qenë fëmija i madh m'kanë ndëgju edhe jonë, nuk po di, m'kanë, m'kanë përkrahë mos me ndrru shkollën.

M'kanë përcjellë çdo ditë n'skollë edhe çdo ditë kanë ardhë mem' marrë. N'atë kohë nuk ka qenë shumë e lehtë me qarkullu sepse megjithatë nuk ka pasë edhe shumë vetura. Prindt e mi kanë pasë veturë por nuk ka, nuk ka pasë vetura mem' endë aq shpesh. Ose autobusat, në at' kohë nuk i kemi përdorë ndoshta edhe shumë. Kështu që, i kom qitë prindve t'mi, tu u rritë, ni telashe ma tepër për me ardhë mem' marrë. Për mos me ma prishë mu idenë e komunitetit t'cilën e kisha kriju atëherë në “Josip Broz Tito”.

Pastaj, memoriet tjera që mbaj n'mend, domethonë gjanat tjera që mbaj n'mend gjatë shkollës fillore janë kryesisht domethanë *uneventfull* [pa gjarje], t'pa ndonjë rëndësie t'veçantë deri rreth klasës pestë, ose klasës gjashtë kur ka fillu.... Po ma merr mendja ky veç osht' viti.... Domethanë unë atëherë, atëkohë dymbëdhjetë vjet, domethanë '88-tën unë i kom pasë dhjetë vjet, '90-tat i kom pasë dymbëdhjetë vjet në klasën, realisht klasa pestë-gjashtë, kur ka fillu segregacioni n'skollë. Kur kemi fillu me shku në, kur ju ka ndrru emri i shkollës, edhe kur kemi fillu realisht me hasë edhe në barriera fizike brenda shkollës, që ne, që i kanë nda paralelet shqiptare prej paraleleve serbe.

Natyrisht, shkolla për shkak t'sistemit paralel ka funksionu n'orare të ndryshme. Klast që kanë qenë me nxënës shqiptar kanë qenë të stërmbushuna. Kanë qenë klasët e mdhaja. Normalisht atëherë, Prishtina ka qenë ma e vogël, po shkolla ka pasë poashtu edhe ma pak. Kështu ndonji ndryshim shumë t'madh në atë kohë, përpos domethanë këtyre barrierave fizike në shkollë që jonë vendosë, që e kanë, e kanë pamundsu komunikimin mes serbëve edhe shqiptarëve. Edhe pse nuk ka pasë, edhe paraprakisht nuk e mbaj n'mend që ka pasë ndonjë komunikim të ngrohtë, po megjithatë jonë kriju, aty kanë fillu m'u kriju këto, qysh me thonë, eksperiencat e dyfishta.

Domethonë vetëm kemi fillu me pa ni realitet t'cilin e kemi jetu n'sistemin paralel të ndarë prej represionit t'cilin kemi, n'vazhdimësi e kemi përjetu. Natyrisht, nuk ka qenë shkolla i vet, i vetmi kujtim. Shkolla ka qenë domethonë barrë. Ka fillu veç me u bo barrë n'kuptimin që o dashtë çdo ditë me shku. Po, ka qenë ma, ndoshta ma mbresëlanëse në atë kohë kanë qenë protestat e ndryshme që mbaheshin në '88-tën, në '89-tën. Edhe ni parehati n'shpi, n'kuptim që prindt vazhdimisht t'preokupumë.

Domethanë, ka qenë kohë kur prindt e mi, baba ka punu në “Rilindje”, nana ka punu në, ka dhonë msim, ka dhonë gjuhë shqipe në Shkollën e Mesme Teknike në Prishtinë, edhe ne si fëmi kemi qenë pak a shumë t'pa mbështjellë, ose t'pa izolim nga, nga bisedat që kanë ndodhë në shpi. Kemi jetu siç

<sup>1</sup> Tash Shkolla Fillore “Ismail Qemali”.

thashë n'banesa edhe shpeshherë i kemi pa.... Prindt tonë kanë qenë domethonë ni klasë e mesme edhe shoqëria e tyre ka qenë klasë e mesme e Kosovës... domethonë gazetarë tjerë, e mbaj mend drejtori Televizionit të Prishtinës në atë kohë, Agim Mala, domethonë kanë qenë miq me prindt e mi, shkrimtarë të ndryshëm, gjithë kanë ardhë – kemi shku nëpër shpija t'tyre.

I kanë pasë pak a shumë fëmijë moshatar tonë, kemi nejt bashkë. Por, prapë po them nuk kemi mujt me qenë plotësisht t'izolum prej çka po ndodhë përtej dritareve. Edhe n'fakt edhe bisedave që shpeshherë kanë ndodhë n'praninë tonë në orë t'vonë, vona, rreth situatës, rreth gjendjes aktuale në Kosovë. E mbaj mend kur ktheheshim prej miqve t'babit në Darda, prej Dardanisë, kur shkonim në Breg të Diellit po besoj në atë kohë, ose ndoshta edhe në Ulpianë ku jemi zhvendosë me vendabim ma vonë, kemi kalu shpesh ka menza e studentëve ku kanë qenë studentët tu protestu brenda menzës. Kanë pasë m'duket në atë kohë grevë urie.

Nëse nuk gaboj duhet me qenë viti '87 ose '88 kur vetëm kanë fillu, domethanë, gjanat m'u përkeqësu në Kosovë. Natyrisht, pak kemi kuptu, unë pak t'paktën kom kuptu për çka po ndodhë, përpos që me ditë që këto shqetësime n'shpinë tonë jonë reflektu...

Atëhere, dajt e mi kanë qenë të angazhum në “Lëvizje Ilegale” edhe, edhe pse si fëmi nuk e kom kuptu ndoshta magnitudën [rëndësinë, peshën] e veprimeve tyre, ose përcaktimin e tyre politik, edhe nuk kom.... Si fëmijë domethonë e mbaj mend që vazhdimisht jonë rujtë prej neve sa herë kanë folë, prej meje n'veçanti si fëmija ma i madh n'familje, jonë rujtë për mos me folë për aktivitetin e tyre. Pjesërisht për shkak se ka qenë ni klimë e tillë në t'cilën je diferencu politikisht, e ki hup vendin e punës, ki qenë pre e bastisjeve, arrestimeve nëse ka pasë ndonjë indikacion që n'fakt je i lidhur me, me lëvizjet e asaj kohe.

Natyrisht, unë as, as sot unë vazhdoj mos me pasë një pasqyrë t'qartë çka n'fakt kanë qenë t'u bo dajtë e mi, përpos që e di që shpitë e tyre kanë qenë shpesh pre e bastisjeve. Edhe e di që, në nifarë mënyre qysh osht' manifestu kjo n'gjendjen tonë n'familje. E di që shpeshherë domethonë kanë ardhë telefonata shumë herët n'mëngjes që i kanë bo pjestarë tjerë t'familjes t'nanës, m'i lajmëru nanës që osht' arrestu ndonjoni prej dajve, ose që shtëpitë e tyre jonë bastisë prapë për armë, për afishe të ndryshme. Edhe e di që, domethonë mandej m'kujtohet... (qanë) nana plotësisht e thyme prej ktyne ngjarjeve që, që domethonë i kanë ndodhë asaj n'familje.

Po, natyrisht gjithmonë me një frikë m'i shprehë ato para nesh. Pjesërisht për shkak që, për shkak t'konsekuecave [pasojave] që kanë mujt me i përjetu edhe baba, edhe ajo e pat... po n'vazhdim, n'vazhdim familja e saj. Njoni prej dajve t'mi, vëllau, njoni prej vllaznive t'nanës ka përfundu n'burg ma gjatë se t'jert. T'jert jonë arrestu kohë pas kohe. Sa herë ka pasë ndoni incident në Kosovë, domethonë ata kanë qenë njoni, ndër familjet që maspari jonë targetu për bastisje, për arrestime. Edhe natyrisht, kanë pasu rrehjet, kanë pasu gjana t'ndryshme që ju kanë ndodhë atyre gjatë burgj... gjatë qëndrimit n'burg.

Nana ka provu domethonë, edhe baba, dytë kanë provu me na mbrojtë prej detajeve, mos m'i ditë detajet çka po ndodhë. Po na kemi qenë fëmi n'fund ditës edhe unë kom bo çmos për me marrë vesh çka po ndodhë, çka, çka realisht çka ju ka ndodhë dajve. Jo që, une prapë po thom, une sot i kom 38 vjet, jonë, ka kalu ni kohë shumë e gjatë prej rreth gati 30 vjeçare prej asaj kohe, po ende nuk i di ndoshta detajet deri në thellësinë e tyre, deri në intimitet, se çka ka ndodhë n'ato vite. Përpos që e di që ata ndihen që kanë kontribu sikur shumë njerëz tjerë që kanë kontribu në Kosovë për gjanat qysh kanë pasu tutje. Domethonë, pavarësinë, shkëputjen e Kosovës prej Jugosllavisë, Serbisë.

Po kjo pak a shumë, domethonë, çka mbaj mend rreth viteve '80-ta, e kom fjalën për '86, '89. Mandej në '89-tën e mbaj mend babën me shokë t'tij tu u mbledhë te na n'dhomë t'madhe edhe tu.... Vazhdimisht e di që, domethonë, ka shku n'punë. E di që ka pi kafe në "Elidë"<sup>2</sup>. Këto i di domethonë si pika kështu të, t'rëndsisht t'jetës tij. Punën në "Rilindje" si, faktikisht si gazetar fillimisht i kulturës, mandej m'duket si redaktor i kulturës në "Rilindje". Edhe domethonë, gazetën që na u ka sjellë çdo ditë n'shpi, qefin për me lexu gazetën, edhe nëse s'kemi kuptu çka po ndodhë.

Normalisht, baba ka punu në rrethana të cenzurës edhe auto-cenzurës të viteve të Jugosllavisë Komuniste. Domethonë, të kohës kur osht' e vërtetë që ki qenë ndoshta i privilegjum me ni vend t'punës po n'shkëmbim t'atij vendi t'punës je dashtë me auto-cenzuru vetën, ose t'paktën me shkru në atë mënyrë, me qenë kritik në atë mënyrë që me leju gazetën me vazhdu me dalë edhe me leju vetën, me ja leju vetës mundësinë me punu. Po, t'njejtën kohë t'u, t'u, t'u kontribu në ni kuptim ma t'thellë t'gjanave qysh kanë ndodhë në Kosovë.

Kjo, '89-tën siç e thashë e mbaj mend ma qartë këto takime në ni grup shumë t'vogël t'njerëzve t'babës, në banesë, edhe ni frikë po t'njejtën kohë edhe ni, ni entuziazëm për rrugën përpara. Domethonë e mbaj mend shpeshherë n'kët' periudhë babin me ni tranzistor n'dorë tu, nëpër dhomë t'madhe, te ne, tu provu m'i ndëgju lajmet e, at' kohë, edicionet serbishtë, nëse s'po gaboj, të BBC-së ose të Zërit Amerikës, Evropës Lirë, domethonë, këtyre radiove... sikur mekanizëm i vetëm që realisht ju patë mbetë, si lidhja e vetme që ju ka mbetë me pjesën tjetër t'botës.

Edhe e mbaj mend t'njejtën kohë shumë vita t'ri që i kemi kalu në, te daj të në Istog. E mbaj mend tu provu me nxañe me gjithfarë mënyra që, që... domethonë, shpeshherë kanë ndoshta edhe t'avancume tek, tek n'masa avancume teknologjike tash për tash, edhe pse primitive në natyrë, me provu me nxañe TVSH<sup>3</sup>-në në atë kohë, emisionet humoristike të TVSH-së për vit t'ri. Sepse n'familjen teme megjithatë, edhe pse kemi jetu në Jugosllavi, nuk ka pasë fortë ide të vllazërim-bashkimit, që ma merr mendja që ka qenë pjesërisht e ndikume prej përvojës t'nanës dhe familjes t'saj me sistemin Jugosllav. Po edhe, edhe t'babës. Domethonë baba ka ardhë, është e vërtetë që ka ardhë prej Malit të Zi, po ka

<sup>2</sup> Ëmbëltore në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve (ish Boro dhe Ramizi) në Prishtinë, e hapur në vitin 1978.

<sup>3</sup> Radio Televizioni Shqiptar i Shqipërisë që në atë kohë nuk kishte sinjal në Kosovë, ose shumë të dobët në rrafshin e Dukagjinit. Më vonë ky kanal shikohej përmes antenave satelitore.

qenë i edukum, i arsimum në frymën e Kosovës, edhe ai e ka ndi edhe e ka adaptu Kosovës si me qenë vendlindja e tij.

Edhe është angazhu politikisht për m'i avancu gjanat brenda Kosovës, me kriju rezistencën, realisht fillet e rezistencës paqësore. Ai ka qenë në grupin e ngushtë t'njerëzve që e kanë themelur Lidhjen Demokratike të Kosovës [LDK] si lëvizje për pavarësi, ose si lëvizje për me kërkë t'drejtnë e Kosovës për shkëputje, njëjtë sikur njësitë tjera Jugosllave. Domethanë, dezintegrimi i Jugosllavisë veç po fillonte edhe shqiptarët e Kosovës... kishte lindë nevoja që ata t'mobilizohen, ose me thanë ma ndryshe ndoshta nëse duhemi me qenë ndoshta pak subjektive, babi me miqtë e tij t'afërt e kanë pa si moment me ju dhanë za kërkesave, m'i formësu edhe me ju dhanë za kërkesave të shqiptarëve të Kosovës. Të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Për me kërkë pavarësi.

Kjo pak a shumë domethonë.... Edhe e mbaj mend.... Duhet me ju thonë edhe qët' detaj se në nifarë mënyre besoj që edhe profesionalisht m'ka (qeshë), m'ka inspiru, që është çudi n'vete. Në atë kohë na si fëmi e kemi shiku Kanalin e tretë na dukej ma, *Treçi kanal*, na dukej ma inovativ edhe ma.... Ka përku me, ndoshta prirjet tona me shiku MTV [*Music Television*], me shiku, me me komuniku në anglisht. Në atë kohë Kanali i tretë jepte seriale, ose programin e natës, edhe m'kujtohet seria "*Midnight Caller*" [Thirrësi i natës] edhe karakteri *Jack Killian*. Ni, nuk e di ndoshta lidhja e parë me botën, lidhja e parë me, me anglishtën ka ndodhë përafërsisht në atë periudhë.

Domethonë, jemi rritë me atë serial. Nuk ka pasë naj, nuk osht' kohë kur ka pasë shumë aktivitete në Kosovë. As në Prishtinë nuk ke pasë shumë. Une nuk e mbaj mend vetën shumë t'u dalë, t'u luft dikund. E mbaj vetën mend ose t'u shiku televizor, ose t'u qenë gjithmonë me këto kujtimet e protestave, kujtimet e ngjarjeve që kanë ndodhë n'familje. Jo shu... jo kurrë pjesë qëndrore e tyre, po gjithmonë diqysh n'margjina duke i shiku deri sa zhvilloheshin.

**Aurela Kadriu:** A u largunë prind't prej punës n'vitet '90?

**Garentina Kraja:** Po. Faktikisht para se t'largoheshin.... Nana punonte n'arsim. Nana, kur ndodhi sistemi paralel, kur faktikisht u murr vendimi me kalu n'sistemin paralel, nana ka vazhdu me dhanë mësim n'teknikë, në shkollë-shpi. Ajo ka pasë, domethonë gjatë të '90-tave e ka lindë motrën e vogël edhe e ka marrë pushim t'lindjes pastaj.

Normalisht, sikur fati i t'gjithëve, edhe "Rilindja" u mbyll. Baba, domethonë aktiviteti i tij si gazetar në "Rilindje" ka pushu me, në minutin kur është mbyllë "Rilindja" në Prishtinë, ose kur osht' mbyllë për ta "Rilindja" në Prishtinë. Ka, baba ka vazhdu me punu në krijimin e Qendrës Informative të LDK-së, Qendra Informative m'duket e Kosovës e ka pasë emrin, QIK. E di që i kanë pasë zyret në Qafë në katin e dytë edhe kanë provu me, domethonë e kanë nxjerrë ni revistë t'quajtur "Ora". Baba n'to ka punu. Domethonë e ka, e ka, realisht ai e ka përmbledhë aktivitetin mobilizues të LDK-së, Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Po siç e thashë edhe fillimisht edhe sot kur provoj me bisedu me te, ideja nuk ka qenë me kriju parti politike, ideja ka qenë me mobilizu lëvizje realisht. Me gjitha defektet e asaj kohe, t'qenurit ndoshta monopolizuse e skenës politike në Kosovë, po megjithatë, për shkak që ka pasë... kauza ka qenë qaq e rëndësishme, edhe ka pasë edhe peshë ndoshta. Lidhja Demokratike e Kosovës ka pasë edhe peshë n'atë kohë edhe nëpër fshatra të Kosovës. Baba ni pjesë t'madh t'aktivitetit tij e ka bo edhe në shtrirjen e LDK-së edhe [nëpër] fshatra edhe nëpër qytete të ndryshme të Kosovës.

Prandaj në këto vite une shumë ma pak realisht e mbaj mend babën n'shpi. E mbaj mend tu u kthy prej terrenit. Tu u kthy prej mbledhjeve t'gjata që kanë ndodhë diku nëpër Prishtinë. Edhe këtë kohë, shumicën e kohës e mbaj mend, domethonë, që e kemi kalu në shtëpi me nanën. Ndoniherë na kanë, jonë përkujdesë për neve studentet ose nxanëse të ndryshme t'mamës që kanë qenë ma t'rrituna, domethonë që mama i ka pasë nxanëse gjatë shkollës t'mesme po tash ato ishin n'fakultet. Edhe mami nganiherë kërkonte ndihmë prej tyre me ardhë me na ruajtë neve tjerëve, fëmive në shtëpi.

E mbaj, domethonë, këtë fazë e mbaj mend që ka qenë hyrje – dalje t'vazhdushme nëpër shtëpi. Frikë e jashtëzakonshme e nanës për babën. E mbaj mend ato të zgjutë deri në orë t'vona, domethonë tu e prit kthimin e tij n'shpi. Ne kemi jetu n'katin e parë në Ulpianë edhe në nifarëë mënyre nana e di shpeshherë, e ka pasë pamjen prej kuzhinës në rrugë, edhe shpeshherë e mbaj nanën... (qanë) e mbaj nanën mend pranë dritares n'pritje të babit.

Në vitin 1992 kur, kur domethonë... une kurrë nuk kom qenë e vetëdijshme që babit ju ka kërk, ju ka kërk faktikisht ju ka rekomandu, ju ka jep këshillë prej miqëve të tij t'cilët ka, kanë ardhë deri te informata që ai osht', arrestimi i tij osht' eminent... unë nuk kom qenë n'dije për këtë. Duket që ka qenë ni moment që ka ndodhë shumë shpejtë. Unë atë ditë jom kthy... kom qenë tu e viju shkollën e mesme në "Xhevdet Dodë". Ne nuk... unë kom qenë... unë nuk kom qenë në shpi-shkollë<sup>4</sup>, por kemi.... Shkollën e kom kry, shkollën e mesme "Xhevdet Dodën" e kom kry n'objektin e saj, sot ku osht' katedralja.

Ka qenë ni objekt shumë i vjetër. E di që shpeshherë kur jemi acar, me njerëz, sepse njerëzit që shkonin nëpër, shokët e shoqet e tjera që shkonin për shembull në "Ivo Llollë", në "Sami Frashër" ma vonë, ankoheshin që po shkojnë, domethonë që përvoja e tyre me shkollim edhe përvoja e neve që ishin në "Xhevdet Dodë" ka dallu shumë. Se ne megjithatë ishim në objekt shkollor. E mbaj mend që mënyra jonë për me i konfrontu ka qenë me thanë, "Po nuk është ajo shkollë. Ajo dikur ka qenë shtallë e kuajve, nuk ka mujtë, nuk osht' shkollë, nuk duket si shkollë". N'fakt ajo osht' dukë ma shumë si shkollë se sa që jonë dukë "Ivo Llolla", ose "Sami Frashëri" ma vonë.

<sup>4</sup> Në vitin 1991, legjislati i Slllobodan Millosheviçit e bëri serbishten gjuhë zyrtare të Kosovës dhe shqiptarët u larguan nga shërbimet publike si dhe nga shkollat. Reagimi i shqiptarëve ishte krijimi i një sistemi paralel të arsimit, i cili u realizua kryesisht në shtëpi private të cilat u dhanë nga familje të ndryshme.

T'paktën na nuk kemi pasë nevojë m'u ulë në tokë edhe me shkru mbi shpinën e njoni-tjetrit. Kemi pasë banka. Edhe, e kemi kriju edhe aty, brenda shkollës, e kemi kriju ni, ndoshta ni realitet paralel me sistemin paralel ku jemi mundu me kriju dinamikë përbrenda qoftë me recitale, qoftë me grupe teatrore, qoftë me gazetë. Ni gazetë t'lodhtë, me thonë mas kështu, po t'paktën ka qenë ni aktivitet që na ka mbajtur neve t'mledhun mas shkollës. Edhe e mbaj mend në vitin 1992, domethonë vitin tim t'parë si gjimnaziste në "Xhevdet Dodë"... përndryshe e jashtëzakonisht e dobët n'matematikë, diçka që m'ka përcjellë me vite pavarësisht sa kom investu m'u përmirësu n'atë lëmi....

Kom qenë gjimnaziste në vitin e parë. Kur jom kthy n'shpi e kom gjetë nanën t'u e bo drekën. Vetëm n'shtëpi, ose ndoshta edhe motrat tjera kanë qenë në shtëpi ose kanë qenë aty para banesës... se shpesh kemi lujtë para banesës. Tash gati e pamundun me imagjinu, por përpara shumicën e ditës ni edukim paralel me edukimin n'shkolle ka ndodhë para hymjes ku kemi lujtë "mes dy zjarreve" [lojë fëmijësh me top], ni lojë t'çuditshme me gurë "xhamija" që i kanë thanë, volejboll... çkado. Ni top e kemi pasë ndoshta krejt lagjja po ai top ka qenë, po thom, shkollimi jonë i dytë si fëmijë, edhe krijimi i njifarë komuniteti brenda hymjes. Pak a shumë gjithë kemi qenë me, me disa vite dallim.

Familjet, qysh, qysh e thashë edhe ma herët, familje t'mesme. Si intelektualisht, domethanë me prindë t'shkollum, fëmi që kemi qenë t'rrethumë me libra. Po, me gjendje socio-ekonomike tepër mesatare, ndoshta a di tejet modeste. S'na ka mungu shumë, po jemi veshë pothujshe t'gjithë njejtë. I kemi pasë niparë farmerka që osht' dashtë, domethonë i ke ble niherë n'vjet, qato i ke veshë për çdo ditë. Patikat, nëse ke qenë me fat atë vit, nuk t'u kanë jep prej dikut tjetër, nuk t'u kanë përcjellë. Për shembull, motrat e mija ju kanë përcjellë prej meje. Ato s'di a i kanë veshë ndoniherë t'reja. Po une me qenë që kom qenë ma e madhja, fëmija ma i madh n'familje, kom pasë fatin me m'u ble t'reja shumicën e kohës (qeshë).

Edhe domethonë pak a shumë gjithë kemi qenë t'veshun njejtë. Gjithë kemi qenë t'ushqym njejtë. E kemi pasë, kemi qenë t'rrethum me t'njejtën literaturë. Përkthimet, që sot kur kthehna i shoh, përkthimet e "Rilindjes" nuk janë t'jashtëzakonshme, po me to jemi rritë. Edhe mandej natyrisht me aktivitete t'cilat na e kanë kriju edhe ma shumë e kanë forcu atë ndjenjën e komunitetit. Po pjesë e pandashme e rritjes tonë ka qenë loja jashtë banesës, para banesës... kështu bash qashtu ju kemi referu 'para banesës'. Edhe ndoshta ni moment i ndritshëm i kësaj fëmijërie, se nuk ke pasë... e ki njoftë, i ki njoftë njerëzit që kanë jetu n'lagje, i ki njoftë fëmijtë edhe ki kriju shoqëri domethonë përbrenda atij komuniteti. T'ka lidhë ma shumë se vetëm t'qenunit fqinjë.

Jom kthy domethonë prej shkollës. E kom gjetë nanën tu e ba drekën. Kom pytë "Ku o babi?" S'kom marrë përgjigje. (Qan) Kom pytë edhe niherë. M'ka thanë, "Babi o dashtë me shku. Nuk dimë kur kthehet. Nuk dimë a kthehet". Ai ka qenë... Edhe normalisht që detajet nuk ka mujtë nana m'i nda shumë me mu se gjithmonë ka ekzistuar ni frikë që nëse dikush vjen me bastisë shtëpinë ose me na marrë n'pyetje, çka guxojmë me ditë ose çka nuk guxojmë me ditë. Sa mundemi me mbajtur msheftë? A ka gjasa që i tregojmë dikujt? Edhe e di që kemi qenë me një heshtje t'jashtëzakonshme edhe ni frikë



t'madhe për fatin e babës (qanë).

Kemi pritë pranë telefonit gjatë tonë ditës për me kuptu ku osht'. Natyrisht rruga nuk na u ka tregu. Na u ka thanë që kur ka mbrri në Shqipëri, me kon'do që ka qenë nana n'kontakt, na u ka thanë që baba ka mbrri mirë, që osht' n'rregull, që, domethonë që nuk ka... që ka shpëtu edhe tashti.... Shqipëria, në atë kohë osht' rrëzu komunizmi. Kanë qenë.... Edhe atje ka pasë trazira. Edhe atje nuk ka qenë situatë e mirë. Po megjithatë, osht' llogaritë që ka mbrri në ni vend t'sigurtë ku nuk ka ma rrezik për te.

Na kemi mbetë domethonë në Prishtinë. N'atë kohë ende, edhepse është hapë Shqipëria, kemi vazhdu me qenë në okupim, ose kemi vazhdu me qenë të rreth... ka qenë n'atë kohë rrethim i hekurit në Prishtinë. Policë shumë. I kemi pasë dikun disa, vetëm disa vende, ku kemi mujtë me qarkullu në '92-tën me sa e mbaj mend unë. Kanë qenë, ka qenë rruga për me, për mu t'paktën, ka qenë rruga prej shkollës deri n'shtëpi, prej "Xhevdet Dodës" deri n'shpi, që ka bo diku rreth dhjetë minuta. Edhe nëse nuk kemi shku n'shpi jemi mbledhë diku nëpër lokale t'vogla t'ndryshme që jonë, kanë qenë hapur, ose n'atë kohë ose rreth asaj kohe, te Santeja, te Kuinsi [*Queens* – ish kafiteri në Prishtinë].

Ato domethonë edhe sot ekzistojnë ai kuart i kafeve në, tu shku drejtë Bulevardit Bill Clinton. Kanë qenë afër shkollës. Aty jemi mbledhë shpeshherë. Masi që e kemi kry shkollën aty kemi shku nëse kemi pasë një markë me vete. Kush e ka pasë ka pi diçka, kush se ka pasë ka ndejtë. Nuk na kanë, nuk na kanë detyru m'u çu prej kafes pse s'kemi pasë mundësi me pagu. Po në përgjithësi domethonë ka qenë, e mbaj mend krejt Prishtinën nifarëë rruge njëkahëshe. Deri te shpija, deri te shkolla, deri te ndonjëna prej këtyre, këtyre kafiqave. '92-ta, '93-ta pak a shumë n'mendjen time mbetën t'tilla.

Çka mbeta pa e përmendë osht' që n'këtë periudhë, domethonë unë kom shku në Amerikë te, m'i vizitu axhtë. Edhe aty kom fillu me mësu anglishtën edhe me pa botën. Me pa njerëzit qysh jetojnë n'rrethana normale edhe me pa që diçka në jetën teme, n'çka une jom realisht e mësume, nuk osht' normë dikun tjetër. Kom qenë shumë e vogël ndoshta për me ditë me artikulu qysh e artikuloj sot këtë dallim, po e di që ka lanë përshtypje, m'ka lanë përshtypje.

Kur jom kthy, sidomos herën e dytë... masanej me motrën n'vitin e dytë t'studimeve, me 16 vjet kemi shku prapë në Amerikë. prapë kemi nejt te axha në, nihere në Connecticut, Norwalk Connecticut, herën tjetër, domethonë herën tjetër jo po një pjesë t'pushimit e kemi kalu të axha në Chicago, te axha tjetër. Edhe përvojat tona edhe përvojat e fëmive të axhës tonë, t'axhëve tonë kanë qenë si dita me natën. E ndoshta edhe kjo, po thomë, kjo ka lanë përshtypje. Nuk di as vet me artikulu qysh osht dukë, po e di që e kom kuptu që mënyra qysh jetojmë në Kosovë, mënyra qysh ka jetu familja ime, prindt e mi në Kosovë nuk osht' normë dikun tjetër.

Edhe gjatë asaj vere sa kom qenë të axha, sidomos herën e dytë, e di që e kom mësu anglishten t'u lexu novela të Danielle Steel, që sot m'vjen (qeshë) marre me pranë që hapat e mirë t'parë n'letërsi jonë bo me librat e Danielle Steel. Po n'fakt e kom pasë, m'ka ndihmu me mësu anglishtën se ka qenë

gjuhë jashtëzakonisht e lehtë për m'u lexu. Edhe kur jom kthy kom qenë e, a di, kom qenë n'gjendje me komuniku lirshëm n'gjuhën angleze.

Tash, t'i kthehna prapë se po boj tejkalime t'ndryshme kështu n'rrëfim, po, po du me ndejtë pranë '92-tës edhe, edhe reflektimit t'largimit babës për neve. Nana ka vazhdu edhe pak me majtë mësim në teknikë. Po, për te u bo shumë domethonë me qenë prind i vetëm që kujdeset për, për neve, për pesë fëmijtë në shtëpi. Edhe ka kërku pushim prej punës. Ne kemi ndejtë në Prishtinë n'banesën tonë. Sepse n'atë kohë edhe përkundër që Serbia ndoshta nuk ka qenë e përqendrome në Kosovë... Kosovën e ka mbajtë në represion t'hekurt policor, po nuk ka pasë luftë. Ka pasë segregacion edhe osht' thellu aparteidi këtu....

Nuk ka pasë, nuk ka pasë liri t'lëvizjes, domethonë na nuk kemi mujtë me shku shlirë në Shqipëri me pa babin. Shpeshherë jemi taku me te... shpeshherë po them kushtimisht sepse ka ndodhë ndoniherë që nuk jemi pa gjashtë muj, ndoniherë ndoshta m'duket një vit ka kalu e nuk jemi pa me babën... e kemi gjetë si teren neutral, ma pak t'frigum për sigurinë e tij edhe sigurinë tonë, me u taku te shtëpia e axhës dhe gjyshes në Ulqin. Këtu kemi, i kemi bo vizitat. Baba nuk ka mujtë me dalë prej shpisë. Baba ka ardhë e ka kalu ilegalisht Liqenin e Shkodrës me barkë për me ardhë për me na pa. Edhe ne kemi udhëtu me autobus. Kemi shku e kemi pa babën.

Natyrisht, kurrë nuk kanë qenë t'lehta se deri n'momentin e takimit ne nuk e kemi... na nuk kemi pasë mobilla [telefona], nuk kemi pasë mënyrë me komuniku lehtë atëherë me pa ku jemi. Po deri sa ne kemi ardhë prej Prishtinës, deri sa ne kemi shku në Ulqin e deri sa ai ka ardhë në, në Ulqin prej Shqipërisë, kemi ndejtë, ndejtë gjithë me ni frikë t'jashtëzakonshme për njani-tjetrin. Këto udhëtime, domethonë shumicën e rasteve kanë qenë pa, jo t'jashtëzakonshme, domethonë komplet kështu të zakonshme ndoshta, përpos n'kohën kur filloj m'u rëndu situata në Kosovë, e kom fjalën për '94-tën, '95-tën.

E atëhere fillun djemtë e ri me i nxjerrë prej autobusit, n'kët' linjën prej Prishtinës për Ulqin, m'i nxjerrë prej autobusit. prapë, e kishim parasysh çka po nodhë, domethonë na i kërkonin, i kërkonin letërnjoftimet, i kërkonin pasaportat. Djemtë që ishin t'moshës luftës, domethonë 18 e përmi, nëse qëllonte ndonjë i tillë në autobus i tërhiqnin jashtë. Gjithë autobusi, askush nuk folte deri sa nuk ktheheshin ata mrenda. Domethonë gjithmonë n'këtë, edhe natyrisht t'u e pasë mbiemnin Kraja shpesh kemi jetu me frikën që mundet me pasë konsekuenca edhe për neve për shkak t'angazhimit t'babit në, në, në krijimin e LDK-së.

Në '92-tën, domethonë babit ju ka kërku me hapë misionin, tash noshta muj me bo edhe ndoni gabim n'data, po ju ka kërku me hapë përfaqësinë e Kosovës në Shqipëri. Edhe kjo ka qenë realisht edhe angazhimi i tij i fundit me LDK-në. Pas kësaj babi ka dhonë dorëheqje prej LDK-së. Mënyra qysh mu m'u ka interpretu si i rritun i vogël n'atë kohë, si adoleshente, ka qenë që ideja e tij mo nuk ka qenë ose vizioni i tij për çka duhet me qenë LDK-ja ma nuk është përputhë me çka, çka është ba LDK-ja. Këta,

baba me shokt e tij, me miqt e tij, e kanë fillu LDK-në si mekanizëm mobilizues, e thashë ma herët si lëvizje për pavarësi, si lëvizje për noshta emancipimin politik të Kosovës, qytetarëve, njerëzve të Kosovës, po mandej kjo osht' kthy në parti politike.

Edhe osht' ky momenti realisht osht' momenti kur baba edhe i këputë marrëdhanjet me LDK-në. Jep dorëheqje edhe e shkrun librin "Vite të Humbura". Domethonë ka këtu normalisht ngjarje tjera t'cilat zhvillohen paralelisht n'jetën e tij. Ai vazhdon të jetoj në Tiranë. Ne vazhdojmë t'jetojmë në Prishtinë. Ai vazhdon me punu në "Rilindje" në ekzil. Ne, unë me motrën, unë me motrat edhe vëllaun vazhdojmë me jetu me nanën në Kosovë. Me vështirësi të ndryshme natyrisht po jo të zak, jo të... domethonë përpos kësaj mungesës t'babës që ka qenë shtesë, na tjerët kemi je, kemi jetu pak a shumë sikur qysh kanë jetu gjithë gjenerata jonë n'atë kohë në Kosovë. E mbaj mend nanën me shoqet e saj t'u u endë prej dyqanit në dyqan t'u kërkua gjana ma t'lira me ble. M'duket që ka qenë përvojë e shumë familjeve kosovare në atë kohë.

## Pjesa e Dytë

*[Folësja vazhdon tregimin nga pjesa e parë]*

**Garentina Kraja:** Paralelisht me këtë, me këto zhvillime familjare te unë, n'shpi ka ndodhë një, rimëkëmbje me thonë, ndoshta as rimëkëmbje jo, po mëkëmbje e gjeneratës teme. Edhe këtu hyn një pjesë e rëndësishme e jetës sime me, fillimisht me kishën katolike në Kosovë, që në atë kohë ka fillu me mbajtë kurse të ndryshme të gjuhës angleze, italiane. Ne e kemi pasë kishën katolike në lagje edhe shpesh domethanë kemi shku te kisha për, sikur aktivitet jashtëshkollor. Ata kanë fillu mandej me na ndihmu me, me bo një gazetë, një fletushkë... sot p'i thom gazetë, sot p'i thom fletushkë, në at' kohë i kena thonë gazetë, se s'kemi pasë ma mirë... në t'cilën jonë, kemi shkru pak a shumë, shkrimet nëse i lexon sot ato duken si hartime me shkrim. Po prapë edhe ajo ka ndihmu domethonë n'krijimin e një komuniteti, njëfarë përgjegjësie, një aktivitet jashtëshkollor.

Për shkak që e pata mësu anglishten ose shpresoja që e kom mësu anglishten në Amerikë, kur jom kthy kom provu me kriju një kurs t'vogël për tjerët, me i'ua mësu tjerëve anglishten. Edhe e mbaj mend që njanën prej klasve t'adaptume brenda kishës, grup, mbledheshim realisht edhe provonim me mësu anglisht. T'njejtën kohë unë kom provu, domethonë kom qenë pjesë e një grupi ma t'gjanë të njerzve, faktikisht të ngushtë fillimisht, të njerëzve që e kanë jetësu, i kanë jetësu "Postpesimistat".

"Postpesimistat" kanë qenë, jonë, kanë fillu realisht, bërthama e tyre ka fillu në shtëpinë e Nora Hafizademit. Nora ka qenë një vajzë e lagjes, e cila ka qenë t'u e studju mjeksinë në at' kohë, n'fakt, n'shkollë t'mesme t'mjeksisë edhe nuk e kom idenë as qysh, po Nora ka pasë kontakte me ja... me njerëz jashtë. Edhe e mbaj mend që fillimisht na kanë grupu një grup t'njerëzve n'banesën e saj. Pa ide t'qartë domethanë, por një ide të një *network*, një rrjeti t'rinjëve, t'cilët janë dallu në atë kohë ose pse i kanë pasë t'gjitha notat pesëshe, ose pse kanë qenë pjesë e aktiviteteve ekstrakurikulare, n'lëmi

t'ndryshme ose n'mënyra t'ndryshme në Prishtinë.

Në atë mbledhje ka qenë edhe Petriti. Une Petritin nuk e kom njoftë domethonë deri në atë moment. Po prej atë, edhe pse kemi qenë n't'njejtën shkollë, kemi qenë në "Xhevdet Dodë"... ose ndoshta ka qenë ky viti i parë në "Xhevdet Dodë" e nuk na ka ra m'u taku ma mirë. Po ne jemi bo bashkë aty dhe mandej kemi vazhdu përtej banesës të Norës. Edhe domethonë ndoshta Petriti mundet me jep detaje ma t'hollësishme se qysh ka ndodhë ky kalim prej banesës të Norës n'banesën e tij, edhe realisht në jetësimin e "Postpesimistave".

"Postpesimistat" kanë qenë, ideja për ta ka qenë t'krijohet një grup i t'rinjve nëpër shtete ose nëpër republika të atëhershme t'ndryshme të Jugosllavisë edhe t'i shkëmbejnë, si një forum i ri i diskutimit, t'i shkëmbejnë me njonit-tjetrin përvojat e shpartallimit të Jugosllavisë realisht edhe çka po kalonin shoqnitë tona nëpër, gjatë këtij shpartallimi t'shtetit. Edhe në t'njejtën kohë t'provojë që përbrenda vendeve t'tyre t'krijojë masë kritike. Tash neve askush nuk na ka mësu që realisht çfarë aktivitete mundemi me bo për me kriju këtë masë kritike. Edhe unë sot nuk thom që na e kemi ditë që jemi tu kriju masë kritike, po kemi shku realisht i kemi mbledhë njerëzit që kanë qenë përreth grupeve tona, mos me thon klikat. Se sot ka klika në konotacion negativ. Po në at' kohë kanë qenë vetëm grupe me t'cilat jemi shoqnu, njerëzve që kanë qenë ose pjesë e "Shpresës" ose kanë qenë pjesë e grupit t'recitalit në "Xhevdet Dodë", ose kanë qenë t'angazhum me forumin rinor.

Domethonë njerëz që kanë ardhë prej, që kanë pas dëshirë me qenë t'angazhum. Tash, për neve që kemi jetu n'sistemin paralel me krejt këtë barrë t'prindve t'papunë, familjeve t'shpartallume si rezultat i rrethanave politike në Kosovë, me këto ngarkesa t'situatës, t'policisë, të segregacionit, t'rrugve një kahëshe realisht... "Postpesimistat" kanë qenë sikur një mes, mes midis këtij realiteti dhe MTV-së. Ne secili përafërsisht nëat' kohë, n'shtëpitë tona e kemi pasë satelitin edhe kemi qenë, e kemi përcjellë muzikën, e kemi, i kemi përcjellë emisionet e ndryshme. Natyrisht na nuk kemi mujt me u veshë si gjenerata jonë, se nuk i kemi pasë kushtet po jemi mundu me aq sa kemi pasë m'u dukë, me kriju një, me e kriju imazhin e një gjenerate. Domethonë, me ecë me normat me t'cilat i thente ose ecte shoqëria ose gjenerata jonë përtej kufive të Kosovës, përtej kufive të Jugosllavisë, përtej kësaj lufte.

Edhe sot mrekullona me qysh kemi mujt me jetu n'këto dy bota paralele. Po ndoshta "Postpesimistat" kanë qenë ai mes që na kanë ndihmu, sepse aty jemi mbledhë pak a shumë njerëz që kemi pasë prejardhjen e njejtë, edhe pse përvojat radikalisht të ndryshme. Edhe besoj që kemi mbrri me kuptu sa t'ndryshme i kemi këto përvoja t'rritjes kur jemi ulë me njëri-tjetrin, jemi vetëdijsu aty përbrenda që jo t'gjithë e kemi përvojën e njejtë, jo t'gjithë p'e kuptojmë çka është tu ndodhë, jo t'gjithë i shohim gjanat njejtë. Edhe ndoshta edhe kjo na ka, na ka homogjenizu me një mënyrë tjetër, na ka ndihmu që q'ai grup m'u bo grup i cili ndigjon pikëpamjet e t'tjerëve. Jo gjithmonë ka qenë lehtë. Për mu ka qenë jashtëzakonisht vështirë, me qenë e ulun në një dhomë ballpërballë, ballpërballë me njerëzit nga Serbia për shembull. Kom pasë paragjykime për ta, i kom fajsu për çka m'ka ndodhë mu personalisht n'jetën time.

Ka qenë e vështirë n'kushtet n't'cilat ne shkolloheshim në Kosovë pa libra, me diktime, me huazime.

Librin për shembull, librin, Albana paradite, masdite une që me mujtë m'i bo detyrat ose m'i bo detyrat n'grup që me mujtë t'gjithë me nda një libër. Ka qenë për mu e vështirë m'i tejkalu këto përvoja personale ditore t'miat për me pasë, për me qenë mendjehapur për pikëpamje ndoshta t'moshatarve t'mi që kanë ardhë nga Serbia. Po mendoj, që në t'njejtën kohë i ke, i kemi senzibilizu ata për gjendjen në t'cilën kemi jetu ne në Kosovë edhe natyrisht kjo ka qenë edhe anasjelltas. Jo t'gjithë kanë qenë fajtorë për politikën e Millosheviçit dhe mbi këtë qasje realisht e kemi ndërtu, e kemi ndërtu edhe frymën e "Postpesimistave".

N'njifarë mendje me pasë, e kemi kriju noshta një universitet paralel me këtë universitetin, universin paralel në t'cilin kemi jetu vet po i cili na ka ndihmu me mbetë, me rujtë, me rujtë veten edhe m'u bo ma mendjehapur për t'ardhmen. Domethonë ka qenë, ideja ka qenë që me "Postpesimista" me provu me projektin një t'ardhme ku lufta kryhet ose nuk nodhë fare. Shpresa për neve në Kosovë ka qenë që nuk ndodhë fare, për moshatarët tonë në Bosnje lufta ndodhte. Ata kur vinin me taku, kanë, e mbaj mend një grup prej Tuzllës. Tuzlla në at' kohë ende nuk ishte pjesë e luftës. E mbaj mend t'u mendu, domethonë t'u i shiku me shumë dhembje edhe tu mendu a do ta kemi fatin e tyre edhe ne.

Natyrisht që fatin e tyre e patëm edhe ne, po në at' kohë ende nuk e dinim. Edhe kemi provu me bo çmos në njifarë mënyre me thy këtë *status-quo* e sistemit paralel, e shkollimit i cili realisht sa vështirë ka qenë me shku n'shkollë për çdo ditë pa e ditë çka ka me ndodhë me ty nesër. E nesërmja n'fjalorin tonë nuk ka ekzistru. E në t'njejtën kohë thom sa vizionare ka qenë me pasë "Postpesimista", me pasë një hapësirë, sot ndoshta *safe* me thonë një *safe space* [hapësirë të sigurtë], ku kemi mujt me shku t'gjithë pi *backgroundve* [prejardhje] t'ndryshëm, edhe me diskutu me mendje t'hapur me njoni-tjetrin.

Brenda këti grupi domethanë po kemi qenë ma t'privilegjum se të tjerët sepse n'këtë kohë në Kosovë nuk është, as nuk është udhëtu, as nuk është... e ne kemi mbri me shku n'konferenca t'ndryshme jashtë vendit. Edhe n'këtë aspekt kemi qenë t'privilegjum. Po në t'njejtën kohë kemi provu që qato përvoja që i kemi pa t'tjerët tu i bo, ne i kemi kthi n'Kosovë, qoftë përmes fletushkës t'cilën e kemi nxjerrë "Postpesimistat" që e kemi shkru, qoftë përmes aktiviteteve të ndryshme, vetëdijësuse ndoshta. Njerëz t'asaj kohe që, ekspozitave t'ndryshme që kemi provu m'i bo ose koncerteve t'ndryshme t'u i mbështetë. Natyrisht, ne fonde nuk kemi pasë, përtej ndoshta pagesës t'nji kordinatori dhe një qërroje.

Për gazetën mbaj mend me Zana Lucin kemi shku derë për derë nëpër bizneset e asaj kohe që kanë qenë me, që i kanë pasë pronarët shqiptar, m'iu kërkru dhjetë marka që me mujt m'i grumbullu paret për me nxjerrë fletushkën. Se normalisht na duheshin pare për me shtypë. Ne nuk paguheshim po na duheshin pare për me shtypë gazetën. Sot nëse i shef ballinat e "Postpesimistave" kanë qenë kreative. Jehona shpeshherë është marrë me, me dizajnimin e tyre. N'shemicën prej tyre jemi ne protagonist domethonë vet njerzit që kemi shkru, vet njerzit që kemi fotografu, vet... Po shumë, e thom, shpesh po ndalna po menoq qysh ka qenë e mundun me pasë një entuziazëm të tillë t'u marrë parasysht gjithçka që ka qenë t'u ndodhë rreth nesh, t'u e marrë parasysht qet' *status-quo*.

Ndoshta ka qenë e vetmja mënyrë që na ka mundësu neve me mbijetu brenda këtyre rrethanave. Kjo domethanë këtë, këtë aktivitet pak a shumë e kemi mbajtur gjallë deri në '97-tën, përbrenda "Postpesimistave". "Postpesimistat" kanë qenë një shpi e dytë. Ka qenë grupi, klubi i debatit, ka qenë klub ku kemi shkruar, ka qenë klub ku i kemi mësu dinamikat brenda grupeve, grup ku i kemi ba shoktë edhe shoqet e ngushta. Une sot hala, sot e kësaj dite, shoqnia jem është përcaktuar prej "Postpesimistave" edhe m'ka formu si, si njeri, m'ka formu ajo eksperiencë, edhe ata njerëz që i kom pasë përreth gjatë këtyre viteve të '90-ta.

**Aurela Kadriu:** Çfare ka qenë natyra e shkrimeve që i keni publiku në fletushkë?

**Garentina Kraja:** Fletushkë (qeshë). Të ndryshme. Unë... njona m' duket ka qenë për shembull, ni numër ju ka dediku skenës t'rokut në Kosovë, në Prishtinë. Osh' shkru për grupet e ndryshme që n'atë kohë, bendet e ndryshme që kanë ushtruar n'gjendje t'mjerushme. Natyrisht po për neve ka qenë ideja që po, po e mbanë rokun t'gjallë përmes këtyre aktiviteteve. I kemi intervistuar njerëzit që, e kemi intervistuar bendet, i kemi intervistuar artistët e ndryshëm që kanë prodhuar art në atë kohë. Ekspozitë, që kanë mbajtur ekspozita t'ndryshme. Domethanë tu ka jep përshtypja, nëse i shfleton "Postpesimistat" sot, t'jepet përshtypja që ka qenë një periudhë shumë e gjallë artistike tu ndodhë në Prishtinë n'kohën e sistemit paralel, që n'fakt nuk ka qenë ashtu.

Këto kanë qenë përpjekjet tepër modeste t'nji jete, t'nji kryeqyteti ose t'nji qyteti. Po për neve ka qenë ndoshta mekanizëm i mbijetesës. Jemi, domethanë përbrenda komuniteteve tona kemi shikuar me i përkrahë, m'i përkrahë gjanat pozitive që kanë ndodhë brenda komunitetit. Në t'njejtën kohë t'u provu me krijë emër për "Postpesimistat". Emër për, s'po du me thonë individualisht për ndonjerin prej nesh, se realisht ne si fëmijë s'kemi pasë ashi ambicie... nuk e mbaj mend që ndonjeri prej neve, ndoshta edhe ka pasë ambicie brenda grupit, po nuk e mbaj mend që ndonjeri prej neve ka mendu dhetë vjet larg edhe çka do t'ndodhë me neve.

Realisht për ne, mu sot m' duket që ato shkrime kanë qenë një, një mekanizëm për me rezistuar *status-kuonë*, për me thy qetë *status-quo* edhe për m'u bo një za alternativ në Kosovë, që jo t'gjithë kemi mendu njejtë, jo t'gjithë jemi, ju kemi përshkruar vlerave t'njejtë t'cilat ju kanë përshkruar ndoshta prindrit tonë. Kjo nuk do me thonë që ne kemi krijuar alternativë politike n'atë kohë, po e kemi krijuar siç thashë edhe niherë, një hapsirë ku t'gjithë jemi ndi t'barabartë, edhe t'gjithë jemi ndi të lirë me diskutuar për, pa paragjykim po shpresoj, për njëni-tjetrin, për përvojat e njëri-tjetrit.

**Aurela Kadriu:** A ka pasë gjatë raportimit t'naj vrasje që është bo në atë kohë?

**Garentina Kraja:** Po. Ne realisht kur u rritëm ka qenë, ka qenë vrasja e Armend Dacit. Armendi... Armendin e kemi njoftë. Ka qenë djali i Prishtinës. E kemi njoftë t'gjithë prej neve n'grup. Ndoshta jo personalisht po e kemi, e kemi ditë kush është. I kemi njoftë edhe shoktë e tij. Edhe kur Armendi është vra, është vra njëni prej neve realisht edhe e kemi pa që lufta na u ka afër, edhe lufta është, është e jona tash. Edhe ajo ka qenë besoj që ai numër n'fakt ka dalë me shirit t'zi, nëse nuk gabohet. Ju ka kushtuar si numër, si edicion Armend Dacit, se e kemi ndi. Nuk është që nuk kanë ndodhë gjana, nuk kanë ndodhë vrasje t'tjera, po kjo na ka prekë neve sepse realisht e ka prekë komunitetin tonë. Edhe

jemi vetëdijsu për, për luftën, jemi vetëdijsu sa afër është edhe sa, se realisht secili prej nesh jemi tash shënjestër.

Mbas këtij raportimi për Armendin, ka qenë edhe një raportim tjetër për një granadë dore që e kemi gjetë prapa zyrate të “Postpesimistave”. Ato zyret tona kanë qenë sot ku ka, ku është “Strip Depo”, aty kanë qenë zyrat, zyrja e “Postpesimistave”. Edhe mbrapa asaj zyre m’duket nëse nuk e gabo, me Jehonën, po m’duket me Jehonën, kemi qenë tu shiku mbrapa edhe e kemi pa një granadë dore. Tani ajo granadë dore, ajo fotografi realisht është bo edhe ballinë e “Kohës Javore”, t’njejtë, me t’njejtin paralajmërim. Se ne n’atë kohë bashkpunonim me “Kohën Javore”. Fillum me dalë si shtesë. Na natyrisht prapë t’njejtën mënyrë i mbledhnim paret sepse ajo duhet t’shtypej nga, nga t’dilte si suplement, si pjesë, si shtojcë e “Kohës”.

Po domethanë kurgjo nuk ka ndrru përpos që kësaj tash fillum m’u bo ma *mainstream*<sup>5</sup>, domethonë dulem prej një fletushke e cila është shpërnda nëpër kafiqa, nëpër shkolla, fillum m’u shitë si pjesë e një reviste politike. Edhe me nda një përvojë tonën që mendonim që është ndryshe prej... m’i dhonë za gjeneratës tonë që realisht nuk ish as gjenerata e prindve tonë, po nuk ish as gjenerata e redaktorëve të “Kohës Javore” n’atë kohë. Ishte një gjeneratë plotësisht e re që po i jepte za, përmes “Postpesimistave”, kërkesave dhe pritjeve t’tyre. Edhe domethonë këto i mbaj mend si dy ngjarjet e fundit realisht n’gazetë.

E mbaj, kur fillum edhe ne m’u rritë, po kur filloi m’u tensionu edhe situata në Kosovë, Armend Dacin edhe gjetjen e kësaj granade t’pashpërthyme mbrapa zyrate të “Postpesimistave” në Prishtinë. Une nuk, domethonë ne ’96-tën e kemi përfund, pi bjen në ’96-tën e kemi përfund, në ’97-tën faktikisht e kemi përfund shkollën e mesme, në ’96-tën vetëm ka fillu me u komunikuar me Shqipërinë ma lirshëm. Domethonë lejohej me shku me pasaportën e Jugosllavisë me shku me udhëtu për Tiranë. Edhe me që u ndryshun këto rrethana, baba tash punonte në “Rilindjen” në ekzil, ne mendum që si familje t’ribashkoheshim. T’shkojmë t’jetojmë në Tiranë mas katër viteve që kishim qëndru ndarë, ndarë prej njeri-tjetrit.

Unë shko... ne t’gjithë shkum në Tiranë. Domethonë ishim n’moshë të shkollës pothuajse t’gjithë fëmijët n’familje. Mu m’binte si gjimnaziste me shku. Gjithmonë me njëfarë *separation anxiety* [ankthi nga ndarja] prej Kosovës. Shkum. Shkova në gjimnazin “Sami Frashëri” në Tiranë. Nji botë komplet tjetër, me probleme krejt t’ tjera. Me shumë paragjykime për Kosovën, me shumë paragjykime çka po ndodhë. Si dikush që ka qenë e emanciupume politikisht, me thanë, ka qenë shumë vështirë për mu fillimisht e kuptu kët’ realitet, sepse Shqipëria me t’cilën unë jom rritë, ka qenë Shqipëria e dajve t’mi, ka qenë Shqipëria e cila, edhe Shqipëria e TVSH-së. Është mendu n’terme shumë romantike për Shqipërinë sikur rezistencë ndaj ndoshta Jugosllavisë, t’cilën prindve t’mi ju ka imponu, ose neve t’gjithve na u ka imponu për me jetu. Edhe e di që dëshprim ka qenë, dëshprim i jashtëzakonshëm... ajo natë....

Mu personalisht “Postpesimistat” m’kanë ndihmu me kuptu perspektivën e tjetrit, se nuk o, jo

<sup>5</sup> Anglisht: *mainstream*, të zakonshëm, të përditshëm.



gjithmonë kom qenë e hapun ndaj asaj perspektive. Pjesërisht për shkak të rrethanave n't'cilat jom rritë edhe t'ngarkesave politike t'cilat m'kanë formësu ma herët se me mujtë me m'formsu shkolla ose rruga. M'kanë ndihmu me e kuptu perspektivën e tjetrit dhe m'kanë ndihmu me qenë politikisht e emancipume, e arsimume politikisht. I kom, nuk kom pasë në asni sekond dilema për çka është tu ndodhë në Kosovë edhe sa ma shumë që jom rritë, qaq ma shumë e kom kuptu sa e paqëndrueshme është gjendja n't'cilën jemi gjetë.

E përshkrupa pak për punën e Tiranës, domethonë iluzionet kur m'u kanë thy mu për Shqipërinë. Në '96-tën kur ne kemi qenë, domethonë kur na ka taku baba n'kufi mes Shqipërisë edhe Maqedonisë, edhe ne kemi vazhdu për Shqipëri, e mbaj mend dikun vonë natën jom zgju edhe kemi qenë diku afër Durrësit m'duket. Edhe nuk mundem as sot me hek at' pamje t'dëshprimit prej kokës time. Rreth për rreth nuk ka pasë kurgjo. Domethonë krejt ajo idea e Shqipërisë idelike, e Shqipërisë utopike të prindve t'mi është thy për dhjetë sekonda t'atyre, t'asaj pamje në Durrës, t'shkretë realisht. Edhe mirë, megjithatë për shkak t'bashkimit familjar, për shkak të nevojës me qenë afër babit, ne kemi vendosë me bo kët' hap edhe me shku me jetu në Shqipëri.

Viti, semestri i parë ka qenë jashtëzakonisht i vështirë për mu. Thashë për shkak t'paragjykimeve që i kemi pa, që i kom pa n'shkollë. Nuk është, nuk osht' që nuk kanë provu me m'integru, nuk është që kom rezistu m'u integru, po nuk ka qenë habitati im i natyrshëm. Në Kosovë i kom pasë moshatarët t'cilët jonë ndi si unë, kanë mendu si unë, ndoshta e kemi përjetu t'njejtën ngjarje kolektivisht. Edhe nëse kemi pasë mendime t'ndryshme, na jemi homogjenizu gjatë këtyre viteve në Kosovë. Edhe osht', jom ndi që jom shkëput prej një pjese t'natyrshe t'timen. Edhe natyrisht që "Postpesimistat" kanë qenë pjesë shumë e madhe e këtijë, e kësaj ndjenje.

Edhe mas një semestri t'vështirë në Tiranë, sidomos me matematikë, o Zot, edhe me biologji, po sidomos me matematikë, unë jom kthy në Kosovë, edhe e kom vazhdu semestrin e dytë në Prishtinë, në "Xhevdet Dodë" ju kom kthy shkollës. Unë edhe motra... ka qenë shumë.... Unë sot e kësaj dite mrekullona me prindt e mij. Unë sot e kom një vajzë pesë vjeçare edhe mendoj a kisha mujt në rrethanat n't'cilat kemi jetu atëherë, në t'cilat është gjindë Kosova atëherë, a kisha mujt me braktisë, jo me braktisë, me lanë vajzën time me shku me jetu dikund tjetër, me një vend tjetër që po, pak a shumë, po shkon drejt luftës? Garant jo. S'ma merr menja që kisha pas zemër.

Po nana na ka besu shumë. Edhe babi e ka ditë që në nifarë mënyre ka ardhë, ndoshta me thonë kushtimisht, është rendi i gjeneratës time me bo ndryshim në Kosovë. Edhe m'kanë leju me ardhë. Edhe ne kemi jetu, unë edhe motra, kemi jetu në Ulpianë. Vetëm. Kemi shku herë mbas here në Shqipëri. Po realisht prindt e m'i pak kanë ditë çka, me çka po merrna une. Sidomos mas 1 prillit t'viti 1997. Edhe ata vet kanë qenë në Tiranë në një kohë jashtëzakonisht t'vështirë, trazirave civile atje pas rrënimit t'skemave piramidale. Kështu që, ne në Prishtinë, ata atje. Realisht n'dy vende n'gjendje lufte. Atje në Shqipëri gjendje lufte civile, në Kosovë ashpërshej represioni serb. Kështu që asnjeri nuk ishim n'vende t'mira, asnjeri nuk ishim t'sigurtë. Po unë besoj që prindt e mi, njona prej arsyeve pse na kanë lonë me shku është se nuk e kanë, nuk e kanë ditë saktësisht çkafit do t'i ekspozohem.j



[Kjo pjesë e intervistës është realizuar më 17 maj]

## Pjesa e Tretë

**Aurela Kadriu:** A mundesh me na folë veç pak për natyrën e aktiviteteve që i ka përfshi krejt shoqata “Postpesimistët”?

**Garentina Kraja:** Domethonë ajo osht', janë zgjeru aktivitetet. Fillimisht kanë qenë ma modeste, domethanë kanë konsistu shpesh vetëm prej takimeve tona deri sa është konsolidu grupi. Ka forma të ndryshme n' t'cilat osht' konsolidu grupi. Kryesisht gjithë jemi angazhu prej njerëzve, domethonë rrethit t'parë, e kom përmendë Petritin në veçanti, m'i sjellë njerëzit që na ka marrë mendja që jonë liderë t'komuniteteve t'tyre, qoftë nxanësa t'mirë n'klasë apo njerëz aktiv që i kemi pa, apo njerëz që kanë qenë të angazhum në aktivitete t'shkollës, ose domethanë të “Sami Frashërit” ose të “Xhevdet Dodës” në atë rast.

Fillimisht, domethonë, pak a shumë aktivitetet tona kanë qenë grupore. Kanë qenë takimet të cilat na i kemi mbajtë në premisat e “Postpesimistave” si organizatë. Mandej, njona prej gjanave t'para që i kemi ba ka qenë botimi i një fletushke, që e ka marrë pastaj trajtën e ni gazete t'përmuajshme, domethonë çdo muj kemi provu m'dukët me, me nxerrë “Postpesimistat”. Kemi pasë aktivitete tjera. Shpesh kemi organizu, sikur me thonë *dance parties* [ndeja vallëzimi], po ma tepër kanë qenë, nuk kanë qenë vetëm *dance party* po kanë qenë edhe ni mënyrë... përpos për m'u mbledhë, ka qenë edhe ndoni bend i asaj kohe. Njerëzit që kanë bo muzikë, njerëz të gjeneratës tonë që kanë bo muzikë, që m'i mbledhë m'i ndëgju ata. Edhe kemi organizu diçka, ndoni aktivitet rreth tyre.

Pastaj, më vonë kur kanë fillu mu formalizu gjanat te “Postpesimistat”, kemi, kur kemi fillu me pasë kordinator... e kemi përzgjedhë kordinatorin që i ka kordinu realisht aspektet e ndryshme të organizatës. Atëherë vetëm kemi fillu me qenë edhe ma formal n'organizim e këtyre aktiviteteve dhe në ofrimin e tyre përtej kornizës t'anëtarëve të “Postpesimistëve”. Ni aktivitet konsistent ka qenë udhëtimet jashtë vendit, domethonë n'formë të takimeve të ndryshme që i kemi bo me “Postpesimistat” që kanë ardhë nga vendet e tjera të ish-Jugosllavisë. Edhe këto pak a shumë e kanë, realisht i kanë dhonë formë aktivitetit tonë brenda Kosovës edhe jashtë Kosovës, gjithmonë n'përgaditje për ndarjen e përvojave tona me moshatart tonë, të Bosnës po m'bin n'mend se ata në atë kohë kanë qenë, veç kanë qenë n'luftë...

Pastaj, me moshatart tonë në Serbi, jo përvojë shpesh shumë, jo shumë e kandshme për mu. Nuk mbaj mend që kemi pasë dikun të Maqedonisë, nuk m'kujtohet. Ndoshta. Po kryesorja, këto kanë qenë dy grupet kryesore edhe normal grupi i postpesimistave në Kroaci që kanë qenë poashtu të organizuar mirë. Kur kemi udhëtu jashtë vendit, domethonë na kemi pasë *workshopa* [punëtori] të ndryshëm me

njerëzit që i kanë sponsorizuar udhëtimet tona. Shpesh kanë qenë, prapa neve si organizatë, financiarisht kanë qenë norvegjezët, shoqatat norvegjeze domethonë, jo shteti... shoqatat e aktivistëve bamirës që kanë pa vlerë n'dialogun ndër-etnik n'suaza të ish-Jugosllavisë. Edhe këto aktivitetet që kanë ndodhë jashtë vendit, kanë qenë, përpos dialogut mes grupeve, kanë qenë edhe mënyrat e ndryshme të trajnimeve që kanë tentu me kriju besim mes komuniteteve të ndryshme, mes "Postpesimistëve" të vendeve të ndryshme.

**Aurela Kadriu:** A mundesh me na përshkru a ka, a ke qenë pjesë e naj udhëtimi? Qëtyne...

**Garentina Kraja:** Po. E mbaj mend që kom qenë në Austri, kom qenë në Norvegji në udhëtimet e postpesimistave. Kemi marrë pjesë pastaj, kur është zgjeru programi, kur kemi fillu me marrë pjesë nëpër shkolla verore. Kemi shku, m'duket me Jehonën kemi shku në Kretë bashkë në kuadër të asaj shkolle verore. Kanë qenë nja tri-katër udhëtimë domethonë, kështu që i mbaj mend qartazi. Kanë qenë domethonë seminarike. Nuk m'kujtohen detajet, po kanë qenë, realisht kanë pasë shumë aspekte shoqërore që i kanë lanë njerëzit mi, që na kanë mundësu realisht m'i thy....

Përpos faktit që na kemi folë për realitetin në t'cilin jetojmë në Kosovë, këto aktivitete t'kanë mundësu m'i pa njerëzit përtej, m'i pa njerëzit si njerëz... përtej asaj ngarkesës që t'gjithë e kishim për t'qenurit domethonë shqiptarë, serb, boshnjak, në atë kohë. Po nuk po më kujtohen specifikisht domethonë çka kanë qenë, përpos debat që shpesh kanë qenë, jonë, ndoshta kanë përfundu n'vaj... aktivitetet e tjera nuk, nuk po m'kujtohen.

**Aurela Kadriu:** A mban n'mend procesin e udhëtimit prej Kosovës deri në vendin e arritjes?

**Garentina Kraja:** Po e mbaj mend. Ndonihere kur kemi udhëtu, domethonë shumë shpesh m'duket që, shumë shpesh kanë ndodhë me autobus udhëtimet tona, po edhe me aeroplan. Kur kemi udhëtu me aeroplan, me sa m'kujtohet mu kemi udhëtu përmes Beogradit. Kurrë përvojë e mirë. Domethanë shpesh herë t'pyt, domethonë tu u frigu që po na marrin n'pytje pse po na... "Pse? Kush jemi? Pse po shkojmë? Çka osht' qëllimi i vizitave tona?" Edhe gjithmonë domethonë mbetet... une, tash lufta ka përfundu që 17 vjet, une refuzoj me shku në Beograd edhe nuk kërkoj mundësi për me shku në Beograd se kom kujtime t'kqija t'kalimit nëpër, nëpër Serbi për transport. T'frikës, jo që na ka ndodhë diçka shumë specifikisht, po t'frikës, kryesisht.

**Aurela Kadriu:** Çka ka ndodhë me juve menihere mbas "Postpesimistëve"?

**Garentina Kraja:** "Postpesimistët"... domethonë, "Postpesimistët" unë nuk e mbaj mend tu u shkurorzu në ni, qysh jom shkurorzu pi "Postpesimistëve", se realisht, ndoshta na formalisht ma nuk kemi qenë pjesë e ni organizate. I kemi lëshu vend edhe rend gjeneratës ma t're se ne. Po çka më kujtohet osht' që unë n'vitin 1996 kur është hapë komunikimi me Shqipërinë, familja e ka pa atë si mundësi për neve me u, domethonë prindt e mi, për neve fëmive me ju bashkangjitë, nana edhe baba

domethonë, me u bashkangjitë familja me shku në Shqipëri me jetu. Kjo ka ndodhë në vitin 1996.

Edhe në përfundimin e shkollës ne kemi shku atje. Edhe për mu kjo osht' realisht edhe shkëputja prej "Postpesimistëve". Pse s'mu ka dukë si shkëputje formale osht' se pak a shumë "Postpesimistat" ma kanë përcaktu shoqërinë, m'i kanë përcaktu njerëzit që unë i kom pasë edhe vazhdoj m'i pasë njerzit shumë t'afërt në jetën time. Nuk do me thanë që pajtohemi. Sot kemi zgjedhë rrugë të ndryshme, por megjithatë jonë njerzt me cilët une kom, vazhdoj me mbetë n'kontakt, vazhdoj me qenë pjesë e gëzimeve edhe hidhërimeve tyre. Kështu që, kurrë nuk e kom ndi që realisht e kom, jom shkëputë... jom shkëputë prej aktiviteteve të "Postpesimistave", po jo prej rrjetit si t'tillë.

Edhe, ne kemi shku në Shqipëri me, me prindt, domethanë me, me tri motrat e mija edhe me vëllaun. Edhe kemi fillu me jetu në Tiranë. Kemi fillu me shku në shkollë. Une kom, une kom qenë në shkollë të mesme. Domethonë vitin e katërt e kom fillu në Tiranë në shtator, me ni brengë shumë t'madhe, domethonë me ni vështirësi t'integritit në Shqipëri. E kom... Shqipëria, domethonë ajo Shqipëria të cilën e kemi gjetë na në '96-tën ka qenë në shpërputhje të plotë me atë Shqipërinë të cilën unë e kom ndëgju prej, prej prindëve t'mij, prej dajëve, prej nanës sidomos. Ka qenë Shqipëri krejt ndryshe. Mbjaj mend pamja e parë ka qenë rreth Durrësit. Dikun afër Rinasit kur jem zgju prej gjumit, domethonë babi ka ardhë na ka marrë n'kufi me Maqedoninë, edhe kur jom zgju edhe e kom pa Durrësin, përreth Durrësit, aty s'ka pasë kurgjo. Ka qenë si një shkretinë.

Edhe ka qenë krejt ndryshe prej qysh e kemi imagjinu Shqipërinë, ose qysh e kemi shiku Shqipërinë me ato antenat ilegale të ndërtume, n'mënyrë domethonë të ndërtume për me kap ni valë të TVSH-së gjatë programit të vitit t'ri. Ka qenë krejt ndryshe edhe ky ka qenë dëshprim i jashtëzakonshëm. Tani Tirana, natyrisht ka pasë ni grup i vogël i kosovarëve që kanë qenë veç n'atë kohë në Tiranë, edhe njani prej njerëzve që ka qenë në Tiranë në t'njëjtën kohë me mu, ka qenë Zana Nixha, domethanë e cila ka qenë veç pjesë e "Postpersimistave" në Prishtinë.

Edhe dyjat kemi përfundu t'u shku në "Sami Frashër" si, si, realisht me vazhdu vitin e katërt të studimeve, të shkollës në Tiranë. Nuk kemi qëllu në klasa t'njejta. Ajo ka qenë në ni klasë tjetër, po t'njëjtën shkollë. Edhe për mu integrimi në Shqipëri ka qenë pjesërisht... se kom shku me idenë që jemi e njejta shoqëri, jemi të njejtit njerëz, ka qenë thymje e madhe. Semestri i parë ka qenë, kom pasë vështirësi me bo shoqëri t're edhe pse ata nxënësit jonë sjellë, jonë sillë jashtëzakonisht mirë, por natyrisht që ka pasë paragjykime prej arsimtarëve. Sigurisht kom pasë edhe unë paragjykimet e mija që i kom projektu n'ta.

Për mu ka qenë e pakuptimtë qysh për shembull arsimtarja e sociologjisë e ka përshtu situatën në Kosovë si "situatë terrorizmi". Atëherë vetëm kishin fillu këto veprimtaritë klandestine, guerile nëpër, nëpër Kosovë. Edhe po t'njëjtën kohë e kom pa edhe ni, ni aspekt tjetër të Shqipërisë t'cilit nuk ju kom ekspozu ma përpara. E ajo ka qenë arsimtarja e gjuhës shqipe e cila m'luste sa herë visha une në Kosovë, m'i sjellë libra. Përkthimet e "Rilindjes" që i kish bo për shembull të, të Gabriel Garcia

Marquezit për shembull, literaturë t'cilën, të shkrimtarëve t'huj t'cilën në Shqipëri, e cila në Shqipëri ka qenë e ndalume. Edhe ata kanë qenë domethonë në '96-tën, kanë qenë tepër t'etur për ni literaturë t'tillë botërore.

Edhe unë i kom shfrytëzu bibliotekën e babës realisht në Prishtinë, sa herë jom endë mes Prishtinës edhe Tiranës, me, me i marrë librat, përkthimet e “Rilindjes”, edhe m'i ja dërgu arsimitares time t'gjuhës. Natyrisht ka pasë edhe momente t'vështira, sidomos rreth gjuhës, mënyrës qysh kom folë unë edhe mënyrës qysh kanë folë, jo, shpesh ka ndodhë mos m'u kuptu. Edhe në përgjithësi kjo situatë ma ka kriju ndjenjën që nuk po du me qenë në Tiranë. Edhe e kom lutë babin nëse mundem m'u kthy. Domethonë, na jemi ardhë për vit t'ri edhe i kom lutë nëse mundem m'u kthy me jetu në Prishtinë me motrën, me Arzanën.

Kemi ardhë. Na kanë leju prindt. Une.... Situata realisht edhe në Prishtinë edhe në Tiranë ka qenë e njejtë, ka qenë situatë kaotike. Në Shqipëri në at' kohë patën fillu, pat fillu rënia e skemave piramidale. Edhe atje pritëshin trazira. Natyrisht kërkujt nuk ja ka marrë mendja që ndodhin trazirat e përmasave t'një lufte civile në Shqipëri. E në Kosovë ka qenë e qartë. Patën fillu vetëm atentatet, patën fillu bombat. Patën fillu atentatet, ka qenë atentati ndaj, nëse nuk gabohem, ndaj rektorit serb të Universitetit të Prishtinës.

E, mandej ka qenë një bombë që është gjujtë te refugjatët e ardhur nga Knini nëse nuk gaboj, nga Kroacia në Kosovë. Po, nuk pat' viktima, po megjithatë fillunë, fillunë vetëm këto aksione t'vogla, veprimtari t'vogla të, guerile, nëpër Prishtinë edhe nëpër pjesë tjera të Kosovës. Fillunë edhe vrasjet nëpër kufi, nxanja e armëve, konfiskimi i armëve. Domethonë u pa që diçka po ndodhë. Domethonë diçka ndodhte n'dyja vendet.

Atëherë, “Koha Javore” ku unë kisha fillu me punu si pjesë e “Postpesimistëve”, filloi, domethonë fillunë, u fillu m'u diskutu që do t'kthehej n'gazetë ditore. Kjo osht' fillimi, fundi '96-tës fillimi '97-tës. Kishin fillu vetëm trajnimet e gazetarëve t'ri që do ta bonin gazetën. Edhe t'u marrë parasysh që unë kom lindë vet me ni familje me babën gazetar, besoj që ka qenë nxitëse. Domethonë fakti që e kom pa çka, rëndësinë e ni mediumi, po edhe për faktin që t'u qenë pjesë e, t'u qenë, t'u u rritë me ni vend që po shkonte drejtë luftës, e kom pasë parasysh rëndësinë e lajmit. Edhe, edhe i kemi përcjellë, përafërsisht prej '89-tës unë e mbaj vetën mend t'u dëgju lajme.

Edhe nuk... edhe nëse nuk kom pasë për qëllim m'u bo gazetare, nëse ajo nuk ka qenë thirrja ime profesionale, dashurinë për shkrimin edhe për lajmin e kom pasë pak a shumë. M'ka përcjellë vazhdimisht gjatë kohës sa jam rritë. Edhe e kom pa si mundësi t'mirë. Mundësi t'mirë për me njoft, për me raportu, për me shku, për me vazhdu me shku, për me vazhdu me intervistë njerëzit. Fillimisht, domethanë “Koha Ditore” ka fillu me, na jemi kthy në Prishtinë, “Koha Ditore” ka fillu me... une kom vazhdu semestrin e dytë t'shkollës të vitit katërt në “Xhevdet Dodë”, jom kthy n'klasën time mas ni semestri.

Ka qenë kthim i vështirë sepse nuk m'i kanë... ma kanë njoftë semestrin që e kom kry në Tiranë, po për shkak të rigorozitetit të “Xhevdet Dodës” mu m’u ka dashtë m’i mësu domethanë edhe krejt mësimet që i kom, që realisht i kanë bo gjatë semestrit t’parë. Mu ka dashtë me i mësu, me i përvetësu për m’u pytë në semestrin e dytë. Ka qenë semestër i vështirë po them, tu marrë parasysh edhe që vetëm e kisha fillu anagazhimin tem, tim te “Koha Ditore”. Nuk i kom mungu klasët, përkundër faktit që kom gjetë punë, që rrallë ndokush ka gjetë punë në at’ kohë në Kosovë. Nuk i kom... kom vazhdu kom, kom shku n’msim. Edhe e kom jep maksimumin për me qenë nxanëse, me vazhdu me qenë nxanëse e mirë.

E mbaj mend atë kohë e kemi pasë profesor të matematikës Mikel Demajn, edhe që pavarësisht kushteve Mikeli ka qenë profesori, ka qenë, i përkushtum me na ba t’gjithëve matematicien. E mbaj mend vetën me gjithë ato problemet që i kishim, me gjithë atë situatë t’paqëndrueshme edhe t’pa, a din t’vështirë, Mikeli... shkojsha n’kurs t’matematikës edhe provoja m’i zgjidhë detyrat n’librin e Bogosllovenit e kemi pasë m’i zgjidh detyrat e matematikës. Edhe në, realisht përfundoj viti i katërt.

Unë po thom prej 1 prillit të ’97-tës kom fillu me punu te “Koha Ditore”. Ka qenë pak a shumë ni ambient i ngjajshëm sikur, sikur diplomim prej “Postpesimistave” në “Kohë”, “Kohë”... domethonë nëse ka ndodhë diplomimi në “Postpesimistave” dikun, atëherë ka ndodhë pak a shumë në “Kohë Ditore”. Në “Kohë Ditore” kom qenë e rrethume me t’njejt, pak a shumë me t’njejt njerëz që kanë qenë në “Postpesimista”, Fisin, Ylberin, sidomos n’veçanti ata dy. Edhe tani e kom njoftu edhe Benin, përndryshe Nebi Qenën. Edhe prej 1, realisht në verën e ’97-tës ai është kthy prej Anglisë. Unë kom qenë veç tu punu, tu i përcjellë evenimentet, ngjarjet kulturore deri vonë, deri dikun në tetorin e vitit ’97.

Në tetorin e vitit ’97, ose shtator, shtator – tetor, me Benin kemi fillu me dal në teren. Kjo ka qenë për mu... unë, domethanë unë jom fëmi që jom rritë në Prishtinë, po kurrë, nuk osht’ që nuk kom pasë njohuri qysh jeton pjesa tjetër e Kosovës se dajt e mi kanë jetu n’fshat. Po, kanë jetu n’fshat në Dukagjin, njerëz t’cilët i kanë pasë tokat pak a shumë pjellore. E kom shpjegu, shpjegova ma heret që janë, kanë qenë njerëz t’persekutumë, domethonë nuk kanë qenë... e kom pasë parasysh çka ndodhë n’fshatra te ne. Po, megjithatë te gjyshi, te dajtë nuk jonë përballë me ni varfëri me t’cilën jonë përballë për shembull në shtatorin e ’99-tës kur kom shku në....

Domethonë, shtatorin e ’97-tës, ose tetorin e ’97-tës ne shku... n’fakt unë i kom pasë atëherë redaktorët, mënyra qysh ka qenë “Koha” e strukturume, ne i kemi pasë për redaktorë njerzit që i kemi njoft përpara. Domethonë ni gjeneratë, Vetoni, Veton Surroi ka qenë kryeredaktori i “Kohës”. Redaktorët tonë kanë qenë Ylber Hysa, Baton Haxhiu, Dukagjin Gorani, Agron Bajrami. Edhe ni pjesë e madhe me bo gazetë ka qenë me bo përkthime t’shumta. Na aty edhe kemi mësu se ka qenë *learning by doing* [të mësuarit dukë bërë], domethonë na nuk kemi pasë shkollim formal.

Unë e kom regjistru juridikun me shpresën që do ta kryj. Kom shku, juridiku në at’ kohë ka qenë

shkollë-shpi në Velani. Po, strukturimi fillimisht ka qenë në gazetë e cila realisht i ka marrë përkthimet... nuk ka pasë gazetarë t'erenit, ka qenë tu u konsolidu. Domethonë shumë korrespondentë nëpër fshatra edhe qytete t'ndryshme të Kosovës. Edhe në grup i t'rive që kanë punu këtu në Prishtinë, gazetarë t'cilët të pa trajnum po t'pa ngjyrosun politikisht, njerëz kryesisht t'orientum n'thyerjen e status-kuos. Tash, po e lashë te puna e Staritërgut.

N'shtator të vitit '97 ka qenë hera e parë, domethonë rreth asaj kohe kur ne kemi marrë guxim në dalë n'teren për me pa qysh jetohet në Kosovë. Edhe ndalesa e parë thashë ka qenë te Stantërgu. As sot nuk e di pse kemi shku atje. Ndoshta ka qenë për shkak se kemi qenë t'prirur me ditë, me, prej nevojës me pa qysh jeton në vend që përpara ka pasë... ose që përpara ose që t'paktën në imagjinatën tonë ka pasë një rëndësi ekonomike si "Trepça". Edhe kur kemi shku, domethonë, si njerëz që na atëherë s'kemi qenë shumë ndoshta të njohur me letërsinë botërore, po si njerëz që e kanë identifikuar varfërinë ndoshta me Migjenin, shkrimet e Migjenit... Migjeni na ka ndihmu domethonë me përshkruar situatën t'cilën e kemi pa.

Në '97-tën kemi shku domethonë në Stantërg edhe kemi taku familje të cilat janë të, realisht e kanë ekzistencën ose ditët e javës me sasinë e millit edhe t'vajit që i kanë pasë në dispozicion. Ky për mu ka qenë realitet t'cilin nuk e kom pa në Prishtinë edhe që nuk osht' reflektu në gazetën e atëherëshme "Bujku", ose në, nuk ka qenë pjesë e diskutimeve në Kosovë, në Kosovë... t'paktën atyre t'cilat kom qenë prezente edhe t'cilat i kom njoftë. M'u ka dukë që në Prishtinë kemi jetu me një ide që gjithë po jetojmë njëjtë, gjithë e kemi vështirë.

Në Prishtinë ka qenë jashtëzakonisht vështirë se kanë qenë, megjithatë aparatusi shtetëror serb ka qenë këtu, ka qenë domethonë në Prishtinë tu e mbajtë shoqinë n'presion. Po ekonomikisht edhe n'kuptim t'izolimit çka kemi pa, çka kom pa unë në Stantërg ka qenë e vështirë m'u shpjegu. Domethonë jemi ulë me Benin, jemi kthy. Mbjaj mend gjatë ton' rrugës nuk kemi folë. Jemi kthy. Ai është ulë në një kompjuter, unë jom ulë përballë tij edhe secili e kemi shkruar verzionin tonë për çka kemi pa në Stantërg. Edhe titullin e ka pasë "Skamja e malit t'artë".

Domethonë ka qenë ballinë. Ka qenë ballinë me, me, e "Kohës Ditore". Realisht shkrimi jem i parë që ka dalë përkun, përtej çështjeve t'kulturës ose intervistave me, me njerëz të ndryshëm të artit edhe t'kulturës në, në Prishtinë. Edhe jom, në tregim relisht, në atë rrëfim jemi pro, kemi provu me i, m'i tregu gjanat qysh i kemi pa, qysh i kemi pa. Mi përshkru edhe m'i sjellë në Prishtinë në realitet pak t'njohur në at' kohë. Ka pasë, unë domethonë kom qenë e pavetdijshme për, për rëndësinë që ni shpjegim i tillë do ta kishte nëpër qytete të ndryshme të Kosovës.

Jom befasu me sa shumë njerëz mas atij rrëfimi kanë ardhë mem' thonë "A përnime po jetojnë njerëzit qashtu?" Jo pse në Prishtinë, prapë se m'duhet, po më duhet me dhanë kontekst, jo pse në Prishtinë gjanat kanë qenë ma mirë, po nuk kanë qenë... Prishtina nuk ka qenë aq e izolime sa kanë qenë ven, pjesët e tjera të Kosovës. Pas këtij udhëtimi me Benin në Stantërg, po tingllon thu se kemi shku me një

shtet tjetër, n'fakt edhe u, udhëtimi edhe ka, o duk' i tillë sepse osht' dashtë me kalu nëpër shumë nëpër, nëpër punkte të ndryshme policore për me mbri deri atje me njiqind tuta. Me njiqind frikë jemi kthy.

Mas asaj kemi vazhdu me idenë, domethonë me shku me pa çka po ndodhë? Çka po ndodhë nëpër fshatra të Kosovës? Çka... a osht', a jemi t'vetdijshëm për, për ku, n'çfarë gjendje o sot Kosova? Se megjithatë, po thom ne kemi qenë një fëmi, ose t'paktën unë kom qenë njëri fëmi që kom, nuk kom, që si kom, s'kom dashtë m'i qëndru besnike status-kuos t'cilën e kemi, kemi, ka qenë e krijume në at' periudhë. Pa shumë ide pak cinike për situatën në t'cilën jetonim, n'pritje t'ndryshimi a ndonjë veprim konkret. Natyrisht veprimin n'atë kohë LDK-ja, lëvizja paqësore, e ka bo për senzibilizim po mas Dejtonit domethonë ka qenë e qartë që na nuk kemi qenë as në agjendë botërore, as n'agjendën amerikane, as n'agjendën e asni fuqie.

Megjithatë, në "Bujku", në "Qendrën Informative të Kosovës" vazhdimisht i ke pasë, lajmet i ke pasë rreth njohjeve, rreth vendimeve t'mdhaja që po, p'e presin Kosovës, që Kosova osht' n'fakt pjesë e agjendave ndërkombëtare. Edhe kjo nuk ka përku me qatë realitet që e kemi pa në Stantërg, që e kemi pa ma vonë në Drenicë të njerëzve t'cilët realisht, për mendimin tim, e kishin hupë secilën... gjithçka... s'kishin mo as çka me hupë. Domethonë e vetmja gja që ju kish mbetë ish mbijetesë edhe jeta. Kaq. Domethonë i kanë hupë, nuk kishin as ushqim, nuk kishin as dinjitet në shumë raste.

Ku.... domethonë Stantërgu ka qenë ajo episoda e parë. Episoda e dytë ka qenë në Drenicë. Në fund t'vitit '97 në Obri të Madhe kemi shku prapë, Obri të Madhe edhe të Vogël, kemi shku me Benin edhe me kolegun tonë të "Kohës" në atë kohë, Visar Kryeziun, fotograf. Edhe, kemi hy me një shtëpi kështu t'ndërtume prej baltës. Nuk ka qenë risi me pa shpija t'ndërtume prej baltës në Kosovë. Ni pjesë e madhe e Kosovës ka qenë e ndërtume ashtu para luftës. Po kjo shpi ka qenë... ka ra bora e parë edhe kjo shpi ka qenë... u duk shumë dramatike. Domethonë shpi pa dritë, me ni dritë shumë t'zbehtë n'fakt mrenda, me ni kulm gjys' t'rrënum.

Edhe hynëm. E pytëm nje, pronarin e shtëpisë nëse mundemi me hy mrenda me bisedu me te. Na lejoi me hy mrenda. Po, kur kemi hy mrenda na e kemi pa realisht ni dhomë. Ni dhomë me mure t'zhveshuna, me... pa tepih, ose me ni batanije shumë t'hollë përmi tokë, n'tokë realisht. Dyshemeja ka qenë tokë e ftoftë. Edhe në atë dhomë e mbaj mend ni dritë, ni llampë e zbehtë. Domethonë kanë pasë rrymë. E mbaj mend ni dollap n'qoshe t'dhomës, disa jastëk për m'u ulë edhe ni nxemëse t'drurit n'mes t'dhomës, ni koftorr në atë kohë që i kemi thanë.

Edhe unë... pronari i shpisë, baba, domethonë fami, kryefamiljari e kish shumë t'vështirë me fol për gjendjen n't'cilën e shihnim ne. Prej përvojës tem në Stantërg e kisha parasysh që gratë e kanë ma t'lehtë me bisedu për problemet, për nevojat e mbijetesës, për mungesat me t'cilat hasen... e sidomos n'sigurimin e ushqimit për familjen. Edhe une kom pytë, "A mundesh t'lutem me m'tregu ku është gruja? A mundem, a din nana e fëmijëve, a mundemi me bisedu me to?" Edhe ai m'ka thanë, "Është, ka

dalë n'kojshi këtu te vëllau". Se tu jetu domethanë n'ato shpitë kështu brenda ni prone, n'bashkësi familjare.

Edhe ju ka thanë fëmijëve, "Hajt shkoni thirrne nanën". Edhe fëmitë n'vend se me dalë prej derës jashtë ata kanë, jonë kthy kah dollapi edhe e kanë hapë dollapin. (Qanë). Në atë moment prej dollapit ka dalë nana... e cila ka ardhë edhe na e ka jep dorën mu, Visarit edhe Benit. Nuk kemi pasë mundësi me pytë kurgjo. Nuk kemi ditë as na qysh m'u sillë (qanë), n'ato momente. Ndoshta rrëfimi ma i vështirë. Domethonë na gjatë luftës kemi pa shumë gjana, po për mu ky mbetet njoni prej rrëfimeve ma t'vështira për me tregu, për faktin se m'u ka dukë se kjo humbja e dinjitetit kur humb gjithçka, ma s'miri m'u ka reflektu në atë gru edhe n'gjestin e saj.

Domethonë ajo nuk ka hy në orman pse ka pasë drojë prej neve, ajo nuk ka hy në dollap pse ka pasë... asaj... unë veç arsyetimi i vetëm ose, a di vazhdoj me mendu edhe sot e kësaj dite për atë gru edhe besoj që njona prej arsyeve pse ajo osht' mshefë aty ka qenë, ka qenë e lidhur me gjendjen në t'cilën e kemi pa. Domethonë humbjen e plotë t'dinjitetit njerëzor. Turp prej gjendjes, prej skamjes. Edhe ky për mu ka qenë paralajmërimi që në Kosovë s'ka kthim.

Domethonë prej kësaj, prej kësaj pike dhe tutje, n'atë udhëtim n'fakt, nëse nuk e gaboju n'atë udhëtim ose dikur, dikur afër përreth atij udhëtimi kemi shku edhe niherë në Drenicë. N'rastin e dytë kur kemi shku kemi fjetë në Mulli, prapë në Obri, unë, Beni edhe Visari. Kemi qenë n'kërkim të UÇK-së. Tash ma ish veç e qartë që UÇK-ja ekzistonte. Na, na tregonin edhe fshatarët nëpër Drenicë kah udhëtonim, domethonë që flitej me shumë kode, me shumë vështirësi. Po, edhe ne domethonë pak n'atë kërkimin, kureshtjen tonë kemi, vendosëm me fjetë me kriju ni besim, realisht me, me fshatart e Drenicës, me njerëzit përreth që nuk e kishim, nuk ish kjo për neve ni aventurë e rastit, që ne realisht na interesonin me ditë kush janë edhe me i kupt... m'i pytë atë, m'i pytë njerëzit në, n'këto fshatra.

Ku... kush ishin UÇK-ja realisht? Sepse nëse UÇK-ja vetëm dilte.... Këtë kohë veç u shtunë thashethëmat që kish njerëz t'maskum nëpër fshatra të ndryshme, sidomos të Drenicës, që i ndalnin veturat, që i pynin njerëzit.... Pynin njerëzit "Ku po shkoni?" Që i legjitimonin, ua merrnin letërnjoftimet me pa kush janë. Nëse domethanë, ata operonin nëpër atë territor, atëherë ideja ishte që njerëzit që, me t'cilët ne do t'flasim, njerëzit e zakonshëm kanë ide për këta njerëz kush janë dhe çka jonë synimet e tyre.

Kështu që, për me kriju besim kemi fjetë atë natë në Obri. Edhe natyrisht jemi taku me njerëz, t'cilët ma vonë e kemi kuptu që kanë qenë UÇK. Neve na kanë taku pa maska. Po t'njejtën kohë tu u kthy prej njonit fshat tu shku n'fshatin tjetër, diku te Obria para Mullinit na kanë ndalë. Na kanë ndalë ni veturë edhe kanë dalë prej saj. N'uniformë pa maska, ni grup i njerëzve. Edhe ne kemi qenë n'veturë me Adem Metën, unë, Beni edhe Visari. Edhe jonë afru. Nejse, e kemi hapë xhamin. Mu kanë drejt, na u kanë drejtu "Kush po mendoni që jeni?" "Qysh mundemi me..."; n'gjuhën shqipe natyrisht. Me t'veshun poshtë, domethonë njeriu që na ka folë ka qenë veshun poshtë me pantolla, nalt me kamufllazhë.



Edhe, “Kush jeni ju? Ka jeni tu shku? Qysh po guxon? Ju shpiuna. Ju, këndej... ju...” Na i kemi tregu që jemi gazetarë të “Kohës Ditore”. Niherë domethanë me, me shpjegimin kush jem, natyrisht ne e kemi pas korrespondentin e “Kohës”, lokal, me vete, që nifarë mënyre ka qenë edhe referencë sepse ata e kanë njoft. Ai ka qenë i Drenicës, i Skenderajit. Kanë fillu me na bërtitë, kanë fillu me na tregu që... me ashpërsu gjuhën. Edhe për ni moment une ju kom kthy edhe i kom thanë “Nuk mundesh me na folë qishtu. Na jemi ardhë deri këtu. Qysh po guxon? Na i kemi kalu punktet. Na i kemi bo këta. Ku p’e din ti kush jom unë? Ku pe din ti ça ka sakrifiku familja jeme?”

Edhe për ni moment o ndalë, m’ka ndëgju (qeshë). Beni edhe Visari nuk kanë folë. S’ka folë as Ademi. M’kanë ndëgju edhe ma ka bo “Okej. Kalo.” (Qeshë) Edhe domethonë, kjo ka qenë përballja e parë me UÇK-në. Ma vonë e kom kuptu që njeriu që na ka ndalë ka qenë, e ka pasë noftën, nofkën Sandokani. Vite mas luftës kom shku e kom intervistu grunë e tij të ndjerë, domethonë grunë e të ndjerit, se ai ka vdekë gjatë luftës, osht’ vra gjatë luftës. Edhe njerëzit e tjerë domethanë që kanë qenë perreth aty nuk kanë reagu, vetëm e kanë lanë vetëm ate me fol. Kur osht’ kry, osht’ kry ky shkëmbimi fjalëve mes tij edhe meje, ne prej atij momenti e kemi pasë t’lirë me shku kudo nëpër, nëpër Drenicë.

Na kanë, nuk na kanë pengu ma tutje. T’nesërmen une kom, kom shku në Prekaz, bashkë me Benin edhe Visarin, edhe me Adem Metën. Edhe në Prekaz na ka pritë, kjo ka qenë dikun mas, besoj mas sulmit parë që ka ndodhë në Prekaz, na ka pritë Hamzë Jashari. Ai ka dalë me na pritë te dera e shtëpisë. Kemi hy brenda edhe na ka tregu qysh ka ndodhë sulmi i parë. Na ka tregu, na ka ba me dore domethanë te pyrgu, pirgu i Fabrikës të Municioneve, ai vazhdon me qenë aty, sikur pikë prej nga ka ardhë sulmi. Pastaj na ka tregu, për afërsisht na ka shëtiti përreth shpive, na ka tregu qysh, ça ka ndodhë atë natë. Qysh ka ardhë sulmi, qysh ka qenë pa paralajmërim, ku jonë lëndu, m’duket dy vajza t’familjes jonë lëndu në atë sulm.

Edhe n’atë moment kur m’ka tregu për vajzat e familjes unë e kom pytë nëse mundem me shku me bisedu me to? M’ka përcjellë. Unë, domethonë pa Benin edhe pa Visarin, kemi shku ni kat përdhesë kanë qenë, ku kanë qenë krejt gratë e familjes. Kom ndejtë pak me to sa për m’i pytë për atë natë. Edhe kur kom dalë prej aty na ka ftu me shku n’odë. Kur kemi, jemi ngjitë te oda nalt, te oda e Jasharajve, unë nuk po di, tash ndoshta edhe a din memorja nganiherë t’tradhëton, po nëse kom pak përkujtim fotografik prej atij momenti dikun nja njiqind palë këpucë kanë qenë para derës. Noshta kanë qenë ma pak, por mu m’u kanë duk si njiqind palë këpucë.

Edhe ai na ka ftu. Ka thanë, “Urdhnoni hyni n’odë”. Po, unë kom qenë e vetmja që kom hezitu. S’kanë hezitu as Beni, as Visari. Ata kanë dashtë me hy. Kom thonë, “A mundemi, s’po hymë hiç? Po kthehemi për Prishtinë.” Pjesërisht sepse ne për me u kthy në Prishtinë osht’ dashtë me kalu nëpër post-bloqe t’policisë, edhe s’po di, ndoshta... (qanë). Na nuk e kemi ditë çka do t’ndodhë realisht, qysh do t’jenë, cilat do t’jenë përmasat e sulmit t’ardhshëm në Prekaz. Po jemi frigu, unë jom frigu personalisht shumë që, noshta që ka qenë edhe... si gazetarë nuk ishe dashtë me pasë kësi lloj auto-cenzure, po tu i

marrë parasysh rrethanat une s'kom dashtë me ditë ma shumë se që m'u ka dashtë me ditë.

Edhe jom frigu me hy n'atë dhomë për me, për njerëzit që po i shoh edhe mundësinë që kah t'kthehna në Prishtinë m'u ndalu prej policisë, m'u sforcu me dhanë informata. Nuk ka ndodhë. Unë nuk kom hy n'odë, por edhe nuk na kanë ndalë. Jemi kthy në gazetë. Edhe tani kur jemi kthy n'gazetë e kemi pasë edhe ni moment tjetër t'vështirësisë qysh me tregu për çka krejt çka kemi pa? Edhe jemi ulë edhe kemi provu me shkru n'mënyrë që nuk i rrez, nuk i rrezikon, nuk i rrezikon njerëzit në Drenicë që i kishim taku, po t'njëjtën kohë e bon shumë t'qartë që jemi taku me UÇK-në.

Edhe si sot e mbaj n'mend që ni fotografi, se Visari... Visarin nuk e kanë lanë shumë me fotografu n'fillim, sidomos për shkak të ftyrave të njerëzve t'përfshirë... po e di që Visari n'borë osht' ndalë edhe e ka bo ni fotografi n'borë. N'borë ka qenë e shkru me UÇK. Domethonë dikush e ka shkru n'borë UÇK. Edhe pak a shumë për neve ka qenë, kjo ka qenë forma me ju tregu lexusve. Se natyrisht, gjithmonë kemi qenë t'u mendu për t'mirën, për mirëqenien personale, për mirëqenien e njerëzve që i kemi intervist, po edhe për mirëqenien e gazetës, se gazetën s'kemi dashtë me e mbyllë. Gazetën kemi dashtë me e mbajtë si mjet t'informimit, mos me e rreziku mbylljen e saj. Edhe, kështu që mënyra e vetme për neve për me tregu realisht praninë e UÇK-së ka qenë përmes asaj fotografije ku dikush e ka vizatu UÇK si parrullë n'borë. Kjo. Po menoj qëkjo ka qenë pjesa e parë.

Në 28 shkurt, pak mas kësaj vizite ka ndodhë Qirez. Vrasjet në Qirez. Kemi pro... nuk e mbaj mend nëse kemi, nëse une kom qenë jesë e ekipeve me shku në Qirez... Nuk kom qenë në Qirez, po i kom pritë fotografitë t'cilat kanë ardhë, që i ka sjellë Visari në redaksi. Jashtëzakonisht t'tmerrshme. Domethanë të njerëzve t'ekzekutum. Kryesisht mashkuj, po ka qenë edhe ni gru shtatëzane. Pastaj ni javë pas Qirezit ka ndodhë Prekazi, me 5 mars të vitit 1998.

Me 5 mars, realisht na atëhere mobilla kemi pasë, i kemi pasë m'duket, mobillat shumë, kanë qenë jashtëzakonisht ekskluziv... ose nuk po di a kemi pasë n'fakt mobilla n'ato ditë apo na ka thirrë, Batoni e ka thirrë Benin në telefon t'shpisë. I kanë pasë, redaktorët tonë, i kanë pasë numrat tonë. Diku shumë herët ka qenë, pa zbardhë ende, ora 5 po m'duket. Edhe i ka tregu Benit, domethonë i thotë Benit, "Po m'duket ka fillu sulmi në Prekaz. A mundeni me ardhë n'redaksi?" Beni m'ka thirrë mu. Kemi shku n'redaksi. Kanë ardhë edhe tjerët. Ka ardhë Fisi, ka ardhë Ylberi.

Kanë provu gjithë ditën, kemi provu n'mënyra të ndryshme, qoftë me numra telefonit që i kemi pasë, qoftë me gazetarë t'huj me provu m'u afru afër Prekazit për me pa çka po ndodhë. Nuk kemi mrrri. Për tri ditë gjatë shtet-rrethimit të Prekazit, nuk kemi mbrri. Kanë ardhë... "Koha" n'atë kohë, "Koha Ditore" ka qenë sikur baza e t'gjithve, sikur ni qendër informative n'vete. Krejt gazetarët e huj kanë ardhë maspari, para se me fillu ditën, kanë ardhë në "Kohë Ditore" me pa çka kemi, çka po ndodhë në Kosovë. Kjo për arsye se njerëzit t'cilët "Koha" i ka marrë n'punë nëpër teren, kanë qenë njerëz shumë kredibil edhe njerëz që vazhdimisht domethonë e kanë mbajtë redaksinë t'njoftume çka po ndodhë.

Kështu që, ne para t'gjithve ndoshta shpeshherë i kemi pasë informatat ku ka luftime, ku ka, ose ku ka sulme n'këtë rast. Ku ka, çka po ndodhë, tek po ndodhë? Kështu që, edhe t'njejtën kohë edhe shumë prej nesh si gazetarë, përpos që kemi qenë gazetarë filloi me u ba e pamundun për neve për me dalë n'teren. Kështu që, shpesh na kemi me ekipe t'huja të gazetarëve të televizioneve t'huja edhe kemi shërby si përkthys tyre. E kur jemi kthy, masi që e kemi kry shërbimin si përkthys, natyrisht na jemi pagu për atë punë po nuk e kemi bo për shkak t'pagesës, kur jemi kthy n'redaksi kemi provu m'i shkru edhe rrëfimet tona.

Domethonë, ka qenë mënyra e vetme sepse si "Kohë Ditore" ne nuk kemi pasë resurse që jonë nevojitë n'atë kohë për me rujt vetën. Ne nuk kemi pasë as jelek antiplumb, as s'kemi pasë vetura antiplumb, domethonë t'blindume, edhe ka fillu m'u bo rrezik për neve me dal n'teren pa kurrfarë mbrojtje si "Kohë Ditore". N'këtë kohë, domethonë ka qenë kohë kur kanë fillu policia me ardhë m'i marrë redaktorët tonë në biseda informative, kanë fillu m'i pytë për shkrimet që kanë dalë n'gazeta. Edhe, domethonë, vazhdimisht e kemi pasë ni, ni ide...

Ne kemi mendu për shkak të relevancës që "Koha" e ka mbri për ni kohë t'shkurtë, me qenë ni lloj, fjalë me përdorë fjalën anglisht *hub* [qendër] për mediat ndërkombëtare, ne kemi mendu, unë t'paktën kom mendu që ajo na e ka dhanë neve edhe nifarë mburoje prej pushtetit. Mburojë ndaj, prej Serbisë. Nuk na kanë prekë, se nëse n'momentin që na prekshin neve boheshim *headline* [titull kryesor]. Domethonë nëse ni redaktor tonin, ose kur, ose ni kryeredaktor tonin e ka rreh policia ai ka qenë, ajo ka qenë titull ndërkombëtar. Edhe kemi besu që kjo domethonë na ka dhonë ni mburojë.

Po edhe fakti që na kemi shku si përkthys të mediave t'huja *CBS, ABC, BBC, Reuters*, na e ka jap neve, personalisht, ni mburojë për me kry punën tonë. Domethonë na kemi qenë dy, i kemi lujtë dy role. Kemi qenë *fixer* [ndërmjetësues] edhe interpretus, s'po thom përkthys se ka qenë n'fakt interpretim se o dashtë me jep edhe kontekst për çka po shohim edhe gazetar. Domethonë dy role t'cilat i kemi, i kemi kry gjatë kësaj periudhe. Ka qenë profesionalisht, për mu ka qenë shkollë n'vete. Gazetare, unë vetën e quj gazetare aksidentale n'kuptim që unë lajmin e kom dashtë, e kom dashtë shkrimin po nuk kom qenë e shkollume për me kry atë punë.

Po n'punën tonë në teren, neve na ka ra '98-tën, '97-tën, '98-tën, '99-tën, na ka ra me punu me gazetarët ma t'mirë. Edhe gazetaria ndërkombëtare n'atë kohë, korrespondentat e huj, e kanë pasë ni përvojë, domethonë ishin veç, vetëm kanë qenë të, e kanë kriju përvojën në Bosne, raportimin e luftës në Bosne, kështu që kur jonë ardhë në Kosovë kanë qenë t'përgatitun për çka po i pret. Ne kemi qenë ma t'papregaditur se ata për çka po na pret. Realisht ajo që kemi pa në Drenicë në '97-tën, '98-tën për mu ka qenë fillimi, ose për mu ka qenë paralajmërimi për qysh ka m'u dukë lufta në Kosovë.

Ka qenë e pa... kur e kemi pa Prekazin domethonë rrënojat e Prekazit, kufomat e Qirezit ka qenë e ditur për neve që kjo është rrjedha e vitit t'ardhshëm në Kosovë. Vitit që po vinte, po, që po shpalosej. Po natyrisht që realiteti ka qenë edhe ma i vrazhdë se sa imagjinata jonë. Kjo noshta edhe si, na ka bo

edhe... realiteti në mes Prishtinës ku jeta ka vazhdu në suaza të represionit, edhe fshatit ku ka pasë vazhdimisht sulme, edhe ka pasë, ka pasë përplasje mes UÇK-së edhe forcave serbe ose ka pasë sulme guerile pastaj hakmarrje disproporcionale që s'ka diskriminu, të Serbisë ndaj fshatrave shqiptare....

Ka qenë pak problem me i pajtu këto dy realitete n'kokat tona edhe shpeshherë na jemi ba, e kemi pa vetën si lajmtartë, gati që lajmtart e asaj çka po vjen. I kemi ditë që kjo noshta osht' nata e fundit me shokët tonë me ni lokal në Sante. Qikjo noshta osht' nata jonë ndoshta e fundit me këta njerëz në "Han të 2 Robertëve". Noshta jo shumë njerëz kanë qenë tu e mendu t'njejtën gja, po për shkak që gjatë ditës kemi, i kemi pa krejt këto gjana tu ndodhë n'teren, jemi kthy në Prishtinë edhe njerëzit na kanë pytë, "Çka po ndodhë allahile?" Ka qenë tepër vështirë m'u ulë edhe me ju tregu çka po ndodhë. Na ju kemi tregu natyrisht për gazetë, s'ka qenë sekret, po ka qenë shumë vështirë me ja u jep njerëzve lajmin që realisht çka osht' tu ardhë osht', po duket shumë tmerrshëm.

**Aurela Kadriu:** Qysh ka qenë komunikimi juj me familjen gjatë kohës sa ke qenë këtu?

**Garentina Kraja:** Jemi ndigju shumë. Domethonë nana ka ardhë na ka vizitu shpesh. Ka provu me ardhë çdo muj me na pa mu edhe Arzanën. Arzana e ka vazhdu shkollën, ndërsa nana ka ardhë na ka taku, ka ardhë na ka pa, ka nejt me neve. Ka udhëtu. Kemi udhëtu edhe ne. Kemi shku me i pa printd, m'i pa edhe motrat, dy motrat edhe vëllaun. Këtë periudhë, domethonë '98-tën unë e mbaj mend, verën e '98-tës, ni pjesë t'madhe t'verës '98-tës kur ka ndodhë, kur ka ndodhë ofanziva në Rahovec. Unë në atë kohë kom qenë në Shqipëri edhe menxi, domethonë menxi kom pritë me u kthy në Kosovë se doja, domethonë kom dashtë me qenë këtu kur kanë ndodhë këto gjana, me raportu për to.

E harrova me përmendë ni aspekt shumë t'randësishëm. Para se me ardhë mediat botërorë në Kosovë, "Koha" ka, e ka, e ka themelu ni rrjet t'informimit n'formën e *newsletter* [buletini] tash, *newsletter* digjitale në anglisht, edhe ni pjesë e madhe e punës tonë u bo edhe aty. Domethonë krejt lajmet që kanë ardhë prej terrenit edhe fotografitë me kriju si ni *digest* [tretje] n'mramje, t'cilin e kemi shpërnda, edhe pastaj ajo ka vazhdu. Domethonë këtu keni parasysh jemi tu fol për vitin '98 ku interneti ka qenë jashtëzakonisht i limitum. Shumë pak njerëz kanë pasë adresa të e-maillit, po me ato kapacitetet tona kemi provu me shpërnda lajmet për çka po ndodhë në Kosovë.

Mas '98-tës, marsit të '98-tës ka qenë e pa, gati e panevojshme sepse mediat kryesore ndërkombëtare kanë vendosë prezencë në Kosovë, edhe Kosova ma nuk është largu prej titujve kryesor deri me 12 qershor të vitit '99.

**Aurela Kadriu:** Qysh ka qenë, po mendoj, '99-shi për juve?

**Garentina Kraja:** Domethonë '98 i ka, '98-ta ka qenë vazhdimisht teren – Prishtinë, teren – Prishtinë, Shqipëri pak. Ka qenë në tetor diku po m'duket, n'tetor të '98-tës ka qenë, osht' lehtësu pak situata se ka fillu armë-pushimi. Po, armë-pushimi ka qenë realisht pregaditje për luftë për të dy palët. Ka qenë

pregaditje për luftë për UÇK-në. Ka qenë pregaditje për luftë për Serbinë. Natyrisht që n'kët' kohë kanë qenë verifikust e OSBE-së, misionit OSBE-së në Kosovë. Edhe tash, shpeshherë, deri, deri domethonë '90 [jo], deri 15 janar '99-tës, shpeshherë n'ta i kemi pa shpëtimtarët. Domethonë që nuk guxon këtu me ndodhë diçka e ni shkalle shumë t'madhe sepse verifikust e misionit të OSBE-së jonë t'pranishëm n'teren.

Me 15 janar kjo gjendje ka ndryshu. Natyrisht, në këtë periudhë vetëm flitej për m'u bo ni konferencë ndërkombëtare për Kosovën. Normal Kosova tash ish e ndame, një anë kanë vazhdu me qenë aktivitetet e LDK-së, n'anën tjetër UÇK-ja. Dyjat, ka pasë tensionet mes dyjave. Ka pasë tensione n'nivelin lokal. Ka pasë tensione deklarative n'nivelin qendror. Ka pasë edhe figura t'cilat kanë provu me kriju ni, ni pajtim mes dy palëve. Po për neve domethonë si gazetarë ne sytë i kemi pasë n'teren. Çka po ndodhë në Kishnarekë? Çka po ndodhë në Llap? Në Llap, sidomos po e përmendi Llapin se në atë kohë nëse ka pasë dikun ku e kemi pa shenjat e, që po fillon m'u ba lufta konvencion, ma konvencionale në Kosovë, ka qenë në Llap.

Sepse gjatë kohës së verifi... misionit verifikus në Kosovë, pranisë tyre, UÇK-ja pat fillu me i hapë istikamet shumë t'thella. Serbia pat fillu me i sjellë veturat, domethonë ma t'sofistikume, mjetet motorrike ma t'sofistikume, t'blindume. Realisht me fut kadal kadale ushtrinë në luftë, m'u bo lufta ma konvencionale. Po thom, për neve, domethonë n'kët' periudhë tetor-janar të '98-tës, përkundër luftimeve që kanë ndodhë n'teren edhe t'cilat kanë pasë, kanë vazhdu m'u raportu... {bie telefoni} m'falni... që kanë vazhdu m'u raportu, diplomacia ndërkombëtare rreth Kosovës ka pasë primat.

Domethonë, edhe nëse i kthehem besoj tash ballinave të "Kohës Ditore" tregojnë që n'atë kohë kemi qenë të, kemi qenë ma shumë tu u marrë me, "Çka tha Kris Hilli, si env, si i dërguari amerikan për Kosovën? Çka tha Millosheviqi? Çka tha UÇK-ja? çka tha LDK-ja?" Domethonë, kanë qenë n'planin politik, ma shumë jonë përcjellë ngjarjet, pa e lanë anash, kryesisht korrespondent ose kanë qenë ngjarje t'cilat kemi shku i kemi mbulu varësisht prej luftimeve sporadike që kanë... sporadike po thom, se megjithatë qenë armë-pushim që osht' mbajtë deri diku n'kët' periudhë.

Domethonë kjo, edhe kjo na ka lanë edhe neve pak mundësi me u largu pak prej terrenit edhe me j'u rikthy narracionit politik të krejt kësaj pune. Kanë vazhdu pytjet me kutpu kush jonë UÇK-ja, n'vazhdim gjatë kësaj periudhe. "Kush jonë këta njerëz?" "Prej nga vijnë?" N'këtë kohë kemi fillu m'i intervistu disa prej komandantëve të UÇK-së. Edhe ata kanë fillu me u bo ma t'hapur me media n'këtë periudhë. Domethonë, osht' fjala për prej verës '98-tës deri te fillimi '99-tës, kur ka fillu edhe u, kur ka fillu m'u marrë vesh emrat e përfaqësuesve tyre politik që kanë fillu me i artikulu kërkesat e tyre politike.

Pastaj, me 15 janar të '99-tës kjo ideja e pranisë ndërkombëtare ka marrë fund se ka ndodhë Reçaku. Edhe, në Reçak unë kom shku dy ditë masi që ka ndodhë masakra, kur i kanë mbledhë, kur u bo ni betejë e madhe rreth trupave. Beni ka qenë ndër gazetarët e parë që ka shku në Reçak. Edhe, domethonë kur është kthy, jonë kthy t'gjithë ai, Ylberi, Batoni, Alban Bujari fotografi. Jonë kthy koxha

t'tmerrum prej asaj çka kanë pa. Civilë të vramë, t'pushkatum realisht, t'hedhun me ni luginë, me ni lug realisht. E kemi raportu ngjarjen, i kemi raportu, e kanë raportu gjitha mediat botërore, edhe kjo osht' pa sikur fundi, realisht fillimi i përpjekjeve ndërkombëtare për konferencë, për me kriju ni, me gjetë ni zgjidhje politike sepse lufta kish fillu prapë, domethonë do t'escalonte në, në Kosovë.

## Pjesa e Katërt

**Garentina Kraja:** Kur kom shku në Reçak, osht' ba ni betejë e madhe atë kohë për, për trupa. Trupat ka dashtë m'i tërhekë prej Reçakut, Danica Marinković m'dukët e ka pasë, Prokurorja Speciale e Serbisë në Kos... faktikisht e Kosovës, po e Serbisë. Edhe njejtën kohë ni mision forenzik e patën dërgu Finlanda, sikur mision forenzik t'pavarur për me verifiku nëse Reçaku ka qenë masakër apo jo, nëse ka qenë ekzekutim i civilëve. Unë e mbaj mend veten, kjo domethonë edhe fshatart, gjithmonë në një anë fshatart, banorët e Reçakut t'cilët provonin m'i varros njerzit që ju kishin vra. Trupat e tyre, trupat e njerzve që, t'krejt atyre njerzve që ishin vra në Reçak kanë qenë t'shtrimë n'xhaminë e fshatit. Nji xhami jashtëzakonisht e vogël fshati.

Edhe tash unë kom qenë aty domethënë me, e kom, kom qenë dëshmitare e kësaj beteje rreth trupave, për m'i marrë trupat në Reçak. T'u përfshi aty identifikimin e, fëmitë që ja u bojshin babave. Njoni prej, prapë momenteve tepër t'rana të, t'kësaj kohe. Mas kësaj në, domethonë ka vazhdu Rambuje, ka ndodhë Rambujeja, kanë ndodhë, ka ndodhë Negociatat e Parisit. Me gjithë ato problemet brenda përbrenda klasës politike të Kosovës, mospajtimeve mes tyre se kush duhet me qenë udhëheqës i delegacionit, çka duhet me nënshkru, çka nuk duhet me nënshkru. Nënshkruhët Rambujeja. I përcjellim, unë n'fakt i përcjelli këto ngjarje për aq sa mundem edhe për aq sa kom pasë rol n'gazetë m'i përcjellë, kur m'u kanë dhanë detyra m'i përcjellë në...

Edhe fillojnë domethonë, jepet urdhri për bombardime me 24 mars të vitit 1999. Tash kur osht' dhanë urdhëri domethanë na kemi qenë ni... e njejtja atmosferë që e ka përcjellë "Kohën Ditore" gjatë tonë ktyne dy vjetve t'punës tonë t'përbashkët, ka qenë, kemi qenë avokus t'fuqishëm t'ndërhyrjes ushtarake ndërkombtare në, në Kosovë, edhe njona prej ballinave që u pat... na nuk e di, na atë kohë nuk kemi punu, nuk ka pasë orar 9 deri në 5. Na n'atë kohë kemi punu prej orës nëntë, noshta kemi shku në nëntë n'punë e kemi, jemi kthy te shpija në dymbëdhjetë ose në një t'natës. Kur ka pasë nevojë kemi ndejtë edhe gjatë tonë natës n'redaksi të "Kohës Ditore" tu përkthi dokumenta t'cilat kanë qenë pjesë e negociatave në Rambuje edhe në Paris, tu provu me marrë vesh çka po ndodhë.

E mbaj mend na pat ardhë n'redaksi m'dukët ni... nuk e, nuk e di n'çfarë forme ka ardhë. Ose ka ardhë si, si propozim ose, ose ka qenë diçka që osht', osht' qarkullu n'atë kohë n'këto *chat groups* [grupe të bisedave] që, që kanë ekzistuar. Ni sllogan që e pat ba Fisnik Ismaili, n'atë kohë i njoftur si kapadaija. Sot Fisi osht' deputet në Vetëvendosje!, i Vetëvendosjes! në Kuvend të Kosovës. N'ate ka qenë llogoja e NATO-s, najket [jo], kta *Nike Air* edhe sllogani i tyre *Just Do It* [Thjesht bëje], edhe ai e pat zavendësu

“Nike” me NATO. Edhe kjo ka qenë ballina e “Kohës Ditore” që unë e mbaj mend si njona prej ballinave t’fundit që i kemi ba në zyret e “Kohës Ditore”.

At’ natë kemi qenë në “Kohë Ditore”. E kemi ndëgju që po mirret urdhëri për, për sulme, edhe pak kemi pasë nocion çfarë do t’jenë këto sulme ajrore realisht, tu marrë parasysh përvojën e Bosnës. Shumë prej neve kemi qenë t’vegjël n’kohën kur jonë, kur kanë ndodhë bombardimet në Bosne. Po, ideja jonë ka qenë që osht’ çështje e 48 orëve, nëse jo 48 atëherë ndoshta 72 orë edhe mas 72 orëve lufta përfundon. Ne mundemi me shku. S’kemi nevojë me qenë n’redaksi, ose shihemi nesër n’redaksi. Po shkojmë shpijave edhe kth... ‘mirë u pafshim’ domethanë për disa ditë.

Domethanë kemi shku, jemi shpërnda nëpër shpija atë natë, mos, tu mos e pasë t’qartë, faktikisht tu shpresu që është çështje ditësh para se kem m’u pa. Edhe n’fakt ma s’miri dëshmi për këta osht’ edhe sasia e ushqimit që e kemi bo gati. Nuk ka pasë ushqim për ma shumë se për ni javë, që e kemi përgaditë që osht’ indikacion që s’kemi pasë ide. Kemi mendu që ka me qenë shumë vendim i shpejtë, me efekt t’shpejtë edhe që do t’kthehen n’tryezën e bisedimeve dhe një zgjidhje do t’gjindet për Kosovën. At’ natë... unë domethanë, unë dhe Arzana kemi jetu n’kat t’parë në Ulpianë, n’banesë t’prindve... edhe jemi ndi që, jemi ndi vetëm, jemi ndi që osht’, osht’ shumë rrezik.

Kemi qenë n’lagje e cila ka qenë e banume prej sërbeve, prej shumë prej tyre zyrtar në “MUP”, në “SUP” realisht në, në Prishtinë në polici. Edhe kemi vendosë me shku me nejt me Benin edhe me prindt e Benit. Edhe, natën e parë me sa m’kujtohet poshtu kemi marrë vendim që nuk osht’ ndoshta sigurtë me ndejt n’banesën e Benit. Kemi shku në Dardani me ni banesë me qira, që e ka pasë motra e Benit me burrin e saj, edhe ata t’njejtën kohë *fiksera* edhe përkthys, interpretus për media t’mdhaja ndërkombtare. M’dukët Safeti për *ITN*-in, Rebeka për *NBC News*, edhe njejtë, njerëz që ju kanë ekspozu terrenit edhe e kanë pa çka po ndodhë gjatë ktyre dy viteve në Kosovë.

Kemi shku, kemi, domethonë Dardania na u ka dukë edhe sikur... pos që s’ka qenë adresë n’emër edhe n’mbiemër t’prindve tanë, nuk ka qenë lehtë e identifikushme. Dardania si lagje ka qenë me shumë banesa. Banesat përmi Kurriz. Na ka marrë mendja që aty osht’ ni zonë ku jemi, mundemi me qenë pak ma t’sigurtë. Edhe aty kemi, jemi strehu për dhjetë ditët e ardhshme. Domethanë bombën e parë n’ora tetë kur ka ndodhë, kur ka, kur, kur, dy-tre minuta para orës tetë me 24 mars, kemi qenë n’atë banesë tu u gzu n’fakt. Shumë tu u gzu për, që po ndodhin bombardimet. Edhe meniherë masi ka, masi e kemi ndëgju bombën e parë, osht’ ndëgju... nuk e di as sot e kësaj dite nuk e di n’fakt ku ka ra bomba e parë... po ma merr menja që në Kazermat e Prishtinës, po osht’ dukë ma e largt. Osht’ dukë sikur me qenë diku te Sllatina ndoshta.

Mas bombës t’parë jonë ndalë rrym, osht’ ndalë rryma, edhe kanë fillu dyqanet në Kurriz m’i thy t’gjitha. E tani k’tu ka fillu vetëm me u, me, kemi fillu me kuptu qysh ka m’u dukë kjo situatë, në Prishtinë sidomos. T’nesërmen e kemi kuptu, kur, kur osht’ ba mëngjes, domethonë kur kemi qenë... nuk kemi pasë dilema që nuk mundemi me dal n’punë. Ka qenë e qartë, s’ka pasë nevojë kërkush me



na thanë. Linjat telefonike kanë punu ende në Prishtinë, edhe e di që kemi qenë n'komunikim me korrespondentin e "Kohës" në Bruksel, me korrespondentin e "Kohës" në Berlin, edhe ata na kanë tregu çka po thojnë lajmet ndërkombtare. Ka pasë, satelitat ende kanë punu. Kemi mujt me pa *Euronews*-in, kemi mujt me pa m'dukët *BBC*-në e *CNN*-in besoj, edhe kemi kuptu që....

Ka qenë domethonë njana prej lajmeve t'para që i kemi marrë t'nesërmen, ka qenë që zyrja, zyrat e "Kohës Ditore" kanë qenë premisat e para të sulmume n'qytet; që avokati i "Kohës" edhe avokati i mirënjohur kosovar Bajram Kelmendi edhe tre djemtë [jo], edhe dy djemtë e tij janë vra. Edhe disa ditë ma vonë e kemi, e kemi, ka ardhë te na me nejt, me fjetë te na n'banesë Batoni Haxhiu. Pak masi ka dalë prej banesës ku kemi qenë na tu u strehu kemi ndëgju që edhe ai osht' i, i mytun. I vdekun, domethonë i vvarë. Kanë qarkullu n'atë kohë rrëfime të ndryshme që e kanë vra derisa ka qenë tu shku rrugës për varrim, n'varrim të Bajram Kelmendit. Ma vonë osht' thonë jo në Bajram Kelmendit po n'fakt Fehmi Aganit.

Domethonë, edhe n'imagjinatën tonë, domethonë tu e njoft Batonin dyjat ishin t'mundshme. Domethonë e kishim përshtypjen që po Batoni e kish ba kta, po Batoni kish shku n'vorrim s'kish, a di.... Edhe kemi dëgju që domethonë roja i "Kohës Ditore" e kanë vra (qanë) atë natë. Bacën Rexhë. Ça ka ndodhë përtej? Kanë vazh... atëherë mas, mas domethonë këto dhjetë netë që kemi nejt n'banesën në Dardani kanë qenë jashtëzakonisht t'gjata. Na s'kemi mujt, asnjani nuk kemi dalë prej shpisë. E di që kartelën e "Kohës Ditore" e kom marrë edhe e kom pre me gërshanë, edhe e kemi gjujt në, n'toilet për m'i hup çdo gjurmë tonën si gazetarë edhe çdo mënyrë tjetër t'identifikimit me, me gazetën.

Pastaj kemi shku, kemi qëndru, kur kanë fillu m'u intensifiku bombardimet kemi ndrru vendbanim. Kemi shku kemi qëndru me ni podrum në Dardani, me shumë njerz tjerë. Kemi shku te nana e Arianës, te prindt e Arianës, jemi strehu te ata, poashtu në Dardani. Ni natë kemi nejt te ta. I kemi shiku bombardimet prej ballkonit. E ka pasë banesën njanën prej katëve t'lartë. Ariana n'atë kohë ka qenë në Austri, edhe jemi kthy prapë n'shpi t'pa... n'këtë banesën e, e në Dardani, t'pa, t'pa qartë çka realisht dojmë me ba edhe qysh po vazhdojmë. Qysh po, qysh ka m'u zhvillu situata.

Kontaktin me prind, derisa kemi pasë telefon e kemi mbajt, po... me babën, i cili e ka ditë vazhdimisht ku jem. Natyrisht na kemi qenë n'përkujdesje t'prindve, edhe unë edhe Arzana, n'përkujdesje t'prindve të Benit. Mas dhjetë ditve, domethonë i kemi fillu m'i pa kolonat. Dikun ni javë ndoshta mas bombardimeve, nëse s'gabo, kemi fillu m'i pa kolonat e njerzve tu ardhë prej Bregut t'Diellit, e nëpër Ulpianë e teposhtë përmu Kurriz, t'drejtume prej, prej dy anve prej policve serbë për me shku në stacionin e trenit. Edhe kemi, domethonë kemi prit kur po vjen rradha jonë realisht.

Me sa m'kujtohet me, me 3 prill, kanë fillu me i zbrazë banesat në Dardani, hymjen ku kemi qenë ne. Edhe na jemi bo gati me çka kemi pasë. I kemi pasë n'atë kohë dy mijë marka m'dukët t'holla, t'gjithë bashkë. I kemi qepë nëpër, nana e Benit na i ka qepë n'pjesë të ndryshme t'teshave me idenë që nëse na ndalon policia, meqë Beni ish i moshës t'rekrutimit, moshës kur munët me luftu, nëse rasisht e



ndalin ate gjatë udhtimit tonë, me shpëtu. Me provu mi, me shpëtu tu ju jep policve pare. Kur kemi dalë prej hymjës edhe ne kemi qenë t'drejtum njejtë. Pjesë e turmës, pjesë e rradhës t'drejtum për stacionin e trenit prej policve me maska.

Domethonë t'gjithë kanë qenë me maska. I kanë pasë uniformat kamuflazhë, po t'kaltërta domethanë njësitë speciale t'policisë. Kemi provu mos me ba kontakt me sy me ta. Jemi drejtu drejt stacionit t'trenit. Edhe n'stacion t'trenit kur kemi mbërri nuk ka pasë... domethonë n'këtë kohë ma nuk kemi mujt me pa as TV se s'ka pasë rrymë, s'kemi pasë as telefon. 3 prilli.... Nuk e kemi ditë as çka po na, sa njerz jonë te stacioni i trenit. Nuk kanë qenë shumë n'kohën kur kemi dalë na sepse ata veç kishin, ish ni pjesë e Prish... e mirë e Prishtinës veç ish zbrazë përmes trenit. Ish pastru etnikisht. Shumë njerz, miq, t'afërm kemi kuptu që kanë, jonë largu. Kanë marrë makinat e tyre, jonë drejtu drejt Maqedonisë, pjesa ma e madhe e tyre, edhe që jonë t'bllokum në autostradën ose rrugën drejt, drejt Maqedonisë, drejt kufirit.

Ne kemi hyp n'tren, po them ndjenjë e tmerrit edhe e frikës, edhe norm... ma shumë n'fakt për Benin se sa për mu, për Arzanën, për Bibin e Muharremin. Ma shumë për te, se atëherë i mbledhnin djemt, domethanë i merrnin ose i ekzekutonin, ose i burgosnin nuk dik... nuk, po e ki.... Kjo ish domethanë, ish ni trend, ni trend t'cilin e kishim përcjellë ne nëpër vet nëpër fshatra ku kish, ku kish ndodhë veç ofanziva që burrat edhe gratë ndaheshin, edhe burrat zakonisht ekzekutoheshin, gjinia mashkullore. Ni frikë e jashtëzakonshme për Benin, çka po i ndodhë Benit n'krejt këtë rrugëtim.

Jemi ndalë diku m'dukët te Ferizaji. Na ka kqyrë ni polic, ka qenë n'platformë, platforma e zbrastë. Krejt Kosova o dukë n'atë kohë me 3 prill sikur ni, ni *ghost town* [qytet fantazëm]. Edhe kur kemi mbërri në Ferizaj osht' ndal pak treni n'platformë. Na ka kqyr ni polic. Ka mendu me hy mrenda. E la, nuk hyni mrenda. Edhe ma deri në Bllace nuk o, nuk osht' ndalë treni. Kur jemi ndalë në Bllace ka pasë polic, domethonë para se me kalu n'tokën e askujt, n'mes Maqedonisë edhe Kosovës, ka pasë polic. Na kanë thanë me dal prej trenit, edhe na kanë thonë me hec nëpër shina t'trenit, nëpër binar t'trenit se pjesa tjetër osht e minume (qeshë).

Kemi ecë, dy për dy mos gabofsha. Kemi ecë edhe kemi përfundu te ni mal me njerz. Në Bllace kanë qenë n'atë kohë, tash s'kom mujt me sy m'i mate, po mu kanë dukë që kanë qenë ni milion njerz. N'fakt kanë qenë diku rreth 30 mijë njerz, t'cilët kanë qenë t'grumbullum, t'cilët Maqedonia nuk i ka lanë me dal. Në Bllace kemi nejt tri netë. Nana dhe baba i Benit kanë dalë prej kampit, kanë mrrri me dalë prej Bllacës m'u largu, edhe pjesërisht për shkak se baba i Benit n'atë kohë ka qenë i smutë me zemër. Ka pasë, vetëm sa e kish kry ni operacion, edhe Kryqi i Kuq domethanë i ka transportu, i ka nxerrë prej, prej kampit. Për neve tjerve ka qenë, kur kanë shku ata, për neve tjerve ka qenë nifarë lehtësimi se n'fund t'ditës ma nuk kemi qenë në Kosovë edhe t'rrezikum drejtpërdrejtë.

Tash gjasat ishin shumë reale që maqedont munden me na kthy, po tu qenë që ishim në *no man's land*, n'tokën e askujt, e kishim ni fije shprese që nuk jemi ma edhe aq t'rrezikum. Situatë jashtëzakonisht e

pa, e papëlqyshme, e pa, e tmerrshme n'fakt në Bllacë. Mungesë t'ushqimit, po ku... ndoshta edhe pak kujt i ka ra n'mend për ushqim, sa ka qenë nifarë, krejt kemi qenë nifarë *survival mode* [gjendje mbijetese]. Krejt tu provu me dal i pari n'rend, për me ikë prej aty për me dal në Maqedoni, për me dal n'anën tjetër. Edhe me ni, ne ke... natën e tretë masi kemi kalu në Bllace, t'nesërmen domethanë e kanë, i kanë sjellë autobusat edhe e kanë zbrazë Bllacën. I kanë çu njerëzit, t'gjithë neve na kanë çu në Stankovec<sup>6</sup> n'kamp.

Unë, Zana dhe Beni kemi qenë n'kamp. E kemi taku edhe, në Bllacë e kemi taku edhe djalin e axhës të Benit, Rronin. Edhe kemi përfundu n'kamp t'refugjatëve. Gjatë ditës, baba ka udhtu prej Tiranës në Maqedoni. Ja ka marrë menja tu i pa lagjet prej ka po dalin njerëzit, e ja ka marrë menja që edhe ne jemi. Pa komunikim se s'kemi pasë mënyrë t'komunikimit. Ja ka marrë mendja që edhe ne kemi dalë në Maqedoni. Ka ardhë në Maqedoni me provu me, me lidhjet e tij me shiku ku i ki, ku jem' na edhe me na nxjerrë prej kampit. Ka mrri me ministrin e atëhershëm t'informimit të Maqedonisë, ka mbri me lutë ate me ardhë me na nxerrë mu edhe Arzanës prej kampit. Na ka nxerr prej kampit. Beni ka mbetë n'kamp.

Benin e ka nxerrë ma vonë ni gazetar i *ABC*-së me t'cilin unë kom punu, producent i *ABC*-së, t'cilin ky e ka njoft edhe i ka thanë, "Unë jom frajeri [i dashuri] i, *Tina's boyfriend*, frajeri i Tinës". Edhe ai ja ka dhanë trajpodin e i ka thanë, "Qe ku e ki edhe kaçketën. Bonu që je pëkthys i jonë". Edhe e ka nxerrë prej kampit. Na jemi taku mandej me Benin në *Holiday Inn* [hotel], në Shkup edhe dytë kemi fillu me punu për *ABC*-në sikur përkthys edhe fiksera të *ABC*-së. Edhe tre mujt e ardhshëm.... Faktikisht, harrova me përmendë që kur kemi dalë prej kampit, baba na ka çu, jemi taku me babën, na ka çu m'u strehu te, te ni gazetar ish kolegë i tij, Selatin Xhezairi. Kemi ndejtë n'shtëpinë e tij disa netë. Edhe pas k'saj baba ka vazhdu për Shqipëri me Arzanën. Une kom va, kom ndejtë me Benin, kom ndejtë me Benin. Kom vazhdu me punu si fiksera e *ABC*-së për tre mujt në Shkup, me vazhdu me përcjellë gjendjen.

N'këtë kohë e kemi kuptu që Batoni osht' gjallë. E kemi, jemi mbledhë një pjesë e ekipit jemi mbledhë sërish bashkë në Shkup, edhe ka fillu me dalë gazeta. Kemi vazhdu ne, unë kom vazhdu me përkthi për *ABC*-në po t'njejtën kohë sa herë kom mujt me shkru edhe për "Kohën Ditore". Kemi jetu bashkarisht, mas ni kohë kemi jetu bashkarisht me disa kolegë. Jemi mbledhë në Shkup kemi jetu n'banesë. Edhe me 12 qershor prapë me *ABC*-në, Beni me 11 qershor, unë 12 qershor jemi kthy në Prishtinë. Kur osht' çliru, kur osht' kry Marrëveshja e Kumanovës.

Njona ndër senet e para që i kemi ba ka qenë me shku m'u taku me Vetonin, me Veton Surroin edhe me shku m'u kthy n'redaksinë e "Kohës Ditore"... me gjetë Halo Trust, agjencinë ose organizatën që e ka ba deminimin në Kosovë fillimisht. I kemi lyp, i kemi gjetë, kemi shku edhe ju kemi thanë a mundeni me kontrollu "Kohën Ditore" për *booby traps*, për mina që kanë mujt m'u vendosë. Kanë hy, i kemi hy bashkarisht i kemi shiku edhe realisht prej atij momenti e tutje ju kemi kthy punës.

<sup>6</sup> Kamp në Maqedoni ku janë strehuar nëpër tenda refugjatët kosovar gjatë luftës në Kosovë në vitin 1998-1999.

Tash, kur u kthym normalisht une shkova n'banesë në Ulpianë. Banesa në Ulpianë e prindve t'mi, i kishin vjedhë shumicën e gjanave t'cilat kanë qenë t'bartshme domethanë tepiha, mobile, çkado t'vlefshme që ju ka dukë njerzve që kanë qenë aty. Kemi gjetë parulla t'shkrume vllaut, si porosi t'lanuna n'mur. Sigurisht djemtë, sërëbt e lagjës. Edhe, po megjithatë domethonë lufta u kry... Me nifarë optimizmi t'jashtëzakonshëm që u kry lufta, që u kthym nëpër shpija. Edhe n'fakt jetën prej xeros gati me fillu duheshim t'gjithë po krejt ish e përballushme që askush nuk kish vdekë prej familjes.

Mujt e parë, domethanë '99-a ka qenë jashtëzakonisht, edhe përfundimi i luftës ka qenë jashtëzakonisht vështirë se tash si gazetarë kemi vazhdu me dalë n'teren, m'i pa pasojat e luftës. Domethanë për këta tre muj që nuk kemi qenë në Kosovë, çka realisht ka ndodhë? Seni i parë që e ki vrejte kur je kthy në Kosovë, ka qenë era. Era e tmerrshme që ju ka ardhë kufomave, bagtive t'mytuna, shtëpive t'djeguna. Ni erë e cila nuk osht' hekë tonë atë verë, domethanë tonë mujin, tonë sezonin e verës. Normalisht ka pasë naj... unë si gazetare kom qenë e preokupume me NATO-n, me UÇK-në, me demilitarizimin, marrëveshjen e demilitarizimit qysh po ndodhë. Kolegtë tjerë kanë qenë t'u e përcjellë administratën e UNMIK-ut edhe, edhe mund, mundsinë e tyre ose për me kriju ni, faktikisht përpjekjet e tyre për me kriju ni, ni gjithpërfshirje, ni, ni, ni bord ose ni komitet gjithpërfshirës politik në Kosovë para se me pregaditë zgjedhjet e ardhshme.

Ka pasë momente t'vështira, sidomos kur, kur kemi pasë t'boj me sulmet që jonë ba ndaj sërëbve. Sulmet që kanë, jonë ba hakmarrëse. Edhe i falenderona "Kohës" n'atë kohë për racionalitetin n'këtë situatë. Ndër zanat e vetëm edhe jashtëzakonisht t'kërcënum n'ato rrethana, që osht' ngritë përmi këtë situatë që u kriju në Kosovë mas luftës, t'dhunës edhe të, të hakmarrjës. E mbaj mend, Vetoni ka, ka shkru ni artikull i cili u ba mandej shumë kontraverz. Ni koment, ni editorial t'tij shumë që u bo kontraverz, që nuk ju pëlqeu shumë njerzve, n'cilën ai bonte apel t'gjanë për m'u ndalë sulmet hakmarrëse, që kjo nuk osht' lloj i Kosovës t'cilin na kemi pasë t'gjithë dëshirë me ndërto.

Rrugt, mas ksaj domethanë, rrugtë pak a shumë tona jonë nda. Kolegtë kanë fillu me lanë "Kohën" për me kërk mundësi tjera ma t'mira. Ndër ta kom qenë eventualisht edhe unë. N'vitin 2000... faktikisht Ylberi ka shku në Amerikë, Fisi ka kalu me punu për *Associated Press*. Beni edhe une kemi vazhdu me mbetë në "Kohë". Beni ka kalu n'televizion të "Kohës". Edhe diku n'vitin 2001, Fisi shkon, ka shku për shkollim, me vazhdu shkollimin në Angli edhe pozita e AP-së [*Associated Press*] ka qenë e hapur. Tash nëse ky ka qenë momenti i t'vërtetës për mu. Nëse du me mbetë gazetarë ose du me ba diçka tjetër me vetën. Unë nuk e kom mbaru shkollimin formal edhe Kosova m'u ka dukë ende që osht' e rëndsishtme, i rëndsishtëm si rrëfim. Kom pasë dëshirë këtë akumulim t'përvojës me pasë ma konstruktiv, domethanë me, me paraqit dikun ku ka impakt ma t'madh edhe ku muj me kriju ndoshta edhe karrierë prej, prej këtij profesioni aksidental.

Kom kalu me punu për *Associated Press* me, i bjen me 22-23 vjet. Kom qenë korrespondentja e tyre në Prishtinë edhe për shtatë vite me rradhë une kom përcjellë, faktikisht gjashtë vite e gjysë, kom

përcjellë zhvillime të ndryshme që kanë, që janë lidhë me ndërtimin e administratës ndërkombtare; paqruajtjen e NATO-s; transformimin e UÇK-së në TMK [Trupat Mbrojtëse të Kosovës]; problemet rreth “TMK”-së; statusin politik t’Kosovës’ t’ardhmen e Kosovës. Po, zgjedhjet e para; zgjedhjet e dyta; domethanë trazirat e marsit 2004; arrestimin, faktikisht arrestimin, ngritjen e padisë të Ramush, për Ramush Haradinaj nga Tribunali i Hagës. Krejt kto domethanë i kom përcjellë derisa në 2000... negociatat në Vjenë t’ekipit t’unitetit për pavarësinë e Kosovës n’planin Ahtisari... krejt kto i kom përcjellë si gazetarë aktive e *Associated Press* që m’ka, për mu ka qenë trajnim i llojit t’vet.

Domethanë k’tu ma, nëse kom pasë, nëse në “Kohë Ditore” kom pasë vështirsi me artikulu, me qenë objektive për shkak t’rrethanave n’t’cilat jom gjetë, në *Associated Press* kom msu që objektiviteti i ndihmon Kosovës edhe i ndihmon shoqërisë, po m’ndihmon edhe mu si individ. Që nuk kom nevojë... domethanë ka qenë agjenci ku i kom jep faktet, ku i kom verifiku faktet, ku kom provu me tregu kontekstin e ngjarjeve n’mënyrë qysh kanë ndodhë. Që për mu ka qenë e rënsishme me pasë informatën e saktë, edhe me pasë informatën e shpejtë, edhe me qenë domethanë, gjithmonë me qenë e para te informata. K’to, kjo, këto kanë qenë parimet mbi t’cilat o vendosë puna në, në *AP*. Ka qenë pak e rënsishme cilit nacionalitet i takon, i takoj edhe kjo ka qenë edhe shumë mirë profesionalisht për mu.

Domethonë ka qenë ni shkallë tjetër e profesionalizimit edhe profilizimit në *AP*. Aty e kom gjetë ni ekip t’jashtëzakonshëm t’njerzve që kanë punu, që e kanë përcjellë luftën po tash qe ju ka mbetë zyrja e *Associated Press* me, me udhëheqë në Kosovë. Kemi vazhdu. Fisi osht’ kthy në ndërkohë. Ka, kemi vazhdu dytë si dy korre... korrespondent të *AP*-së. Kom fillu me, me mbulu ngjarje poashtu edhe në Maqedoni edhe në Shqipëri kur osht’ dashtë, kur ka pasë nevojë. Edhe kët’ situatë pak a shumë deri n’vitin 2006 ka vazhdu e ktillë.

Në 2006-tën ka ardhë ni moment tjetër. Çka du me ba me vetën? Tash, prindt fillunë me punu, me, ju rikthynë jetës t’tyre. U rindërtu shtëpi... domethanë jeta jonë ju kthy normalitetit mas nontë vjetve. Edhe ideja ke çka, çka tutje? Unë provova me ju kthy, m’u kthy në Universitet të Prishtinës. E pata, e kisha shumë t’vështirë m’u kthy. Pjesërisht për shkak që m’njihnin njerëzit edhe i njihja, ndoshta edhe në mungesë t’seriozitetit edhe t’pjekurisë me ju kthy studimeve. M’dukej prapë që profesionalisht kisha ma shumë afinitet me qenë gazetarë se me ju përkushtu studimeve. Dyjat t’njejtën kohë nuk, nuk kom mujt m’i ba. Po kur fillunë gjanat m’u relaksu n’familje, domethanë me pasë, me pasë t’ardhuna stabile prindrit, me, me pasë, me pa që situata në Kosovë po qetësohet, atëherë pata, ka qenë ndoshta momenti i vetëm edhe i parë kur unë kom mujt me, me mendu për vetën.

Këtë situatë, ma s’miri si dukët e ka pa, e kanë pa njerëzit tjerë përreth meje t’cilt m’kanë ndihmu, m’kanë nominu për ni *fellowship* [bursë] në Yale, t’cilin e kom marrë edhe aty m’u ka hapë dera për me ba diçka që nuk kom pasë mundësi me ba kurrë, që ka qenë m’i kry studimet edhe me provu me kriju ni normalitet për vetën. Në 2006-tën, si pjesë t’këtij *fellowshipi* kom shku edhe jom interesu nëse mundem me i, m’u kthy m’i vazhdu studimet ose m’i fillu prej fillimit. Natyrisht, në Yale ka qenë vështirë me hy me edukimin, me shkallën e edukimit, t’arsimimit që e kom marrë unë në Kosovë. Sidomos mas ni pauze dhjetë vjeçare.

E kur them pauzë dhjetë vjeçare, po flas që n'vi... n'vitin 1000... n'vitin 2007, 2006, 2006-2007, pothuj që matematika për mu ka qenë inekzistente. Unë kom ditë me mbledh, me, me pjestu, me shumzu, po operacione të komplikume matematikore që t'duhët për me kalu, bazike që t'vyn me kalu provimet e SAT<sup>7</sup>-së për m'u pranu në Universitete prestigjioze, s'i kom, jonë zhdukë ato aftësi, edhe nëse... Domethonë gjithmonë e kom pasë vështirë, po tash kanë qenë mas dhjetë vjetve pauzë, kanë qenë, ka qenë shumë vështirë me ju rikthy. Domethanë, çka duhët me ba për me i përmirsu rezultatet e mija t'testeve t'pranimit.

Edhe mu m'u ka dashtë me ju rikthy matematikës prej fillimit, edhe kom shku krahas punës teme në AP edhe seriozitetit t'ngjarjeve të Kosovës n'vitin 2006, unë kom shku për çdo ditë n'kurs t'matematikës. N'kurs t'statistikës për me msu matematikë prej fillimit. Ka qenë, s'e di, sot thom ndoshta me kto, me këtë a e kisha përsëritë. M'u ka dukë jashtzakonisht lehtë për qëllimin, për me mbrii qëllimin që kom dashtë, që ka qenë për m'u pranu me ni Universitet prestigjioz, edhe me, m'i ju rikthy kti normaliteti. Edhe ka qenë ndoshta lajmi ma i mirë prej Kosovës mas luftës, kur n'vitin 2007, në maj t'vitit 2007 e kom marrë lajmin që jom pranu në Yale.

Atëherë, normal kom qenë para vendimeve t'mëdha. Kom qenë me Benin, me Benin që ishim bashkë n'atë peirudhë. Veç ishim bashkë dhjetë vjet. Çka me ba? A me shku, a mos me shku? A me lanë një profesion t'tanë edhe m'u kthy prej pikës xero? Qysh me ja ba? Edhe me përkrahjen e t'gjithve, edhe shumë njerëzve, *it takes a village*, duhët një fshat për me, për me çu nji, ni njeri n'shkollë ndoshta. Jom shku, kom shku kom fillu me bursë t'plotë studimet në Yale. Kur kom shku e kom ditë saktësisht çka po du. E kom ditë që po du me studju shkencat politike, jo pse kom pasë ndonji ide t'qartë çka du me ba ma vonë me ato studime politike, me shkenca politike, po kom dashtë me kthy, përvojën tem kom dashtë me provu me kthy në diçka t'shkrume. Diçka që osht' mësim për, për situata t'ngjajshme.

Nuk di sa kom mbrii me ba kta, po unë kom, mas katër vjetve mund, kom diplomu me *Cum laude* [me mirënjohje] prej *Yale University* [Universiteti Yale], në shkenca politike, edhe gjatë ksaj kohe m'u ka dhanë mundësia, domethanë Yale e ka pasë një mundësi për studenta t'shkencave politike që nëse donë brenda ktyre katër vjetve munden me marrë landë shtesë t'nivelit t'studentave t'doktoraturës, edhe master, nëse donë me ba edhe ni master. Edhe kta e kom ba. Kështu që, e kom provu m'i kompenzu brenda ktyre katër viteve gjana t'cilat m'u kanë duk' që jonë marrë prej meje me forcë.

Çka ka qenë tjetër, qysh ka qenë, shpeshherë m'vesin, m'pysin njerëzit "Qysh ka qenë shkollimi në Yale?" Për mu viti i parë ka qenë ankth i vërtetë. E mbaj mend veten kur kom shku n'klasën e Steven Smith, filozof, politikë, Filozofi Politike, edhe ai ka pytë krejt klasën ni auditorium prej 200 vetve, i ka pytë nëse i dinë reshtat me t'cilat hapet "Iliada". Edhe unë s'e kom ditë. Domethanë nuk osht' që nuk e kemi lexu n'shkollë, po pauza e gjatë mes shkollimit, natyrisht se kom pasë idenë. Po kom shpresu që

<sup>7</sup> SAT - *Scholastic Assessment Test*, Testi për Vlerësim Shkollor, i prezantuar për herë të parë në vitin 1926, është testim i aftësive akademike të studentëve, kusht për pranim në universitete amerikane.

jom në ambient ku nuk e dinë as njerëzit e tjerë, edhe pak a shumë kjo e përshkruan qysh jom ndi une n'atë vitin e parë. Kur e kom kthy kokën e kom pa krejt auditoriumin (qeshë) dorën nalt. Domethonë për mu ka qenë e qartë që unë duhet me, për vitin e ardhshëm, unë duhet m'u mbyll n'biblotekën e Yale-it edhe me mësu, me kompenzu krejt çka nuk i ka, i kom msu gjatë viteve t'shkollimit formal edhe joformal në Kosovë.

E, ndoshta edhe kjo ka qenë edhe vështirësia ma e madhe ose sfida ma e madhe e këtyre viteve, që mu m'u ka dashtë me, me balancu mes shkollimit joformal edhe shkollimit formal që e kom pasë, t'përvojës t'jashtëzakonshme jetësore, profesionale gjatë luftës në Kosovë edhe tranzicionit edhe rigorozitetit akademik, t'ni institucioni akademik. Edhe domethonë natyrisht unë kom shku n'shkollë me njerëz që kanë qenë kryesisht, sidomos dy vitet e para, dhjetë vjetë ma t'ri se unë. Edhe ajo ka qenë ni, ni shok i veçantë. Po, n'fund ka përfundu mirë.

Pas kthimit, pas diplomimit jom kthy në Kosovë. Nuk kom pretendu, kom shiku mundësi tjera për me mbetë në Amerikë. Nuk m'u kanë dukë shumë atraktive. Nuk m'u ka, nuk e kom pasë edhe vullnetin tepër t'madh për me kërkë diçka, patjetër për me mbetë jashtë. Kom dashtë m'u kthy në Kosovë, m'u kthy te familja, m'u kthy te Beni n'veçanti. Edhe kur jom kthy kom fillu me punu për Presidenten Atifete Jahjaga, si kshilltare për, fillimisht për siguri pastaj edhe për politikë t'jashtme. Për pesë vjet kom qenë, kom punu te Presidentja me, me sfida t'ndryshme. Ka qenë një mandat i vështirë. Për ata njerz që jonë t'njoftun me situatën politike t'këtyre viteve në Kosovë, ka qenë vit, kanë qenë vite, pesë vite t'polari... t'polarizimit t'skajshëm t'skenës politike në Kosovë, edhe t'pamundsisë n'fakt t'frustrimit tepër t'madh... edhe pse je ni pozitë ndoshta që ki shpresu që t'u qenë *insider*, tu qenë përbrenda mundësh me ndryshu. Mi ndryshu gjanat në Kosovë. Ni demoralizim kur nuk mundësh. Domethonë kur e sheh sa, sa, sa i parëndsishtëm ndoshta osht' individi brenda ni sistemi.

Për mu ka qenë, gjithmonë e kom pasë kureshtjen nëse për mu osht' e rëndsishtme, domethonë ma e rëndsishtme osht' me qenë jashtë derës t'vendim-marrjës a brenda. Tash i di dy anët e kësaj përvoje. Kom qenë shumë kureshtare me ditë qysh osht' me qenë mrenda. E di. Tash e di. Edhe kanë përfundu pesë vjet. Unë jom shumë falendëruar n'fakt. M'pysin njerëzit qysh ndihem për faktin që i kom kalu pesë vjet n'institucione të Kosovës. Jom hy me ideale... me idealizëm, kom dalë me dëshprim ndoshta, po me ni dëshprim që nuk po mundem me ba ma shumë, po n'fund t'ditës me ni përvojë jashtëzakonisht t'vlefshme t'kyre viteve t'shërbimit.

Pse ka qenë, për mu ka qenë shumë e rëndsishtme me punu për ni, ni njeri i cili nuk osht', mas pari n'pozitë nuk osht' pjesë e partive politike se nuk, nuk, nuk e kom paramendu vetën kurrë si pjesë t'strukturve partiake ku duhësh me shërby interesa t'caktum ose agjenda t'caktume politike. Kom mendu që t'u punu për ni Presidente e cila vjen me ni, prej ni prapavie krejt tjetër, mundem me dëshmu ma s'miri atë idealizmin tem për Kosovën. Natyrisht tash osht' shumë herët për mu me vlerësu at' periudhë, për ate edhe po jom ma e shkurtë në, n'kët periudhë, se osht' ende shumë e freskt për me mujt me nxerrë msime.

Pra, t'u e thanë kta unë prapë po thom osht' kry edhe aty. Shpresoj që ni ditë kom me mujt me i nda momentet e caktume prej punës te Jahjaga, te zyrja, te stafi i Jahjagës, për me... nëse për kurgjo atëherë për me kuptu, për me i mundësu tjerve me kuptu qysh kanë qenë kto vitet t'konsolidimit të Kosovës si shtet. Ku kanë qenë sfidat kryesore? Pse ndoshta ngjarjet kanë marrë rrjedhën që e kanë marrë? Pse sot jemi dëshmitarë të situatës n'cilën jemi? Po, për momentin nuk, nuk mendoj që ka kalu shumë kohë as për mu. Une jom, osht' vetëm ni vit prej që kur e kom lëshu atë punë edhe e kom pak vështirë me, me jep vlerësime t'prera për shembull për, për atë kohë.

**Aurela Kadriu:** Edhe, mbas?

**Garentina Kraja:** Edhe mbas, po. Në, në dhjetor të, faktikisht n'shtator të vitit 2016 derisa unë punoja te Jahjaga, Beni ka pasë mundësi për avancim profesional. Ne e kemi pasë ndërkohë, se harrova me përmën, ni moment shumë t'rëndsishtëm, jom bo nanë n'vitin, në korrik t'vitit 2012. Nana e Dalies. Tash, domethanë për mu ka qenë, gjatë ton' jetës jom njoftë si çika e Mehmet Krajës, gruaja e Nebi Qenës, tash m'u ka shtu edhe ni epitete. Tash jom nana e Daliës (qeshë). Kështu që, tjetër, çka të... domethonë Daliën që pesë vjet.... M'vjen shumë keq se n'kohën kur, kur e kom lindë Daliën kom qenë shumë e angazhune në zyrën e Presidentes edhe gati që nuk e kom, i kom nda realisht rritjen e saj edhe me njerzt tjerë. Me familjen, me dadon e saj, me Benin, po nuk kom qenë njiqind përqind me te.

Kështu që kur u, kur Benit i erdh mundësia për, për avancim profesional si producent i lartë në mbikqyrje të Izraelit dhe Palest... territoreve Palestineze, atëhere m'u duk si moment shumë i mirë edhe për mu vet me ba ni pauzë. M'u tërheqë, edhe me shku m'i ju rikthi Daliës si prioritet, edhe njejtën kohë m'i ndihmu me qenë përkrahse e Benit. Ai ka qenë përkrahës i jashtëzakonshëm i imi, sidomos n'ato vitet t'shkollimit. Unë nuk besoj që kisha mujt me diplomu prej Yale-it, edhe nuk besoj që kisha pasë qetësinë, ose jo qetësia osht' fjalë e gabushme se ato vite kanë qenë gjithçka pos qetësi. Nuk besoj që e kisha pasë, shtyllë t'përkrahjes për ato katër vite në Yale kanë qenë....

Ka qenë nji gru e cila ka qenë fillimisht zëvendës drejtoreshë e programit Yale, *Yale World Fellows Program* [Programi Botëror i Studjuesve në Yale], Kel Ginsberg që m'ka shty edhe n'ato momente kur unë jom dorëzu, kur kanë qenë 24 orë para se me dorëzu aplikacionin për me apliku në Yale. Ajo m'ka lutë me kry eseun, *Admissions Essay* [ese për pranim]. Anën e cila, Anna Di Lellio, e cila ka qenë me mu n'çdo hap edhe besoj që ka qenë ndoshta njeri që mas shumti e ka kuptu sa vështirë edhe sa e rëndsishtë ka qenë me kry këtë etapë, me përmbyllë këtë etapë për mu. Edhe, natyrisht Beni që ka besu që muj me kry (qanë). S'po di çka me, nuk kom tjetër...

**Aurela Kadriu:** Edhe mandej shkut në Jerusalem?

**Garentina Kraja:** Po kemi shku në Jerusalem. Tash te Jerusalemi. Jerusalemi.... Domethanë, une jom, unë jom shku në Jeruslalem n'dhjetor të 2016-tës pak, n'prag të përfundimit t'mandatit të Presidentës.



Kom vazhdu me i këshillu me, me, me e këshillu Presidentën n'rolin tim që e kam pasë, po tash prej nifarë distance. Domethanë kom vazhdu m'i shkrujt fjalime, që ka qenë njona prej, kom vazhdu m'i shkrujt fjalime që ka qenë njëra prej detyrave t'mija. Jo ekskluzivisht e imja, po njëra prej detyrave t'mija në, në stafin e Presidentës, deri në prill. N'prill kur e ka përfundu Presidentja mandatin, atëherë kom ardhë m'dukët n'qershor në Kosovë. I kom dorëzu telefonat, gjanat tjera që kanë mbetë me mu prej mandatit, edhe e kom përmbyllë realisht aktivitetin tim në institucione të Kosovës.

Edhe prej ati momenti... E kom pasë një vit jo shumë t'lehtë në Jerusalem. Jashtëzakonisht vend interesant. Osh't shumë mirë që jom atje me qenë përkr... n'përkrahje të Benit edhe mundësi për m'i ju përkushtu ma me vëmendje Daliës. Po, personalisht pak i vështirë se p'e shoh që osht' edhe ni moment tjetër ku m'duhët me rizbulu vetën edhe me, me rizbulu çka du me ba tutje. Edhe këta pas një peri... një viti domethanë qëndrimi në Jerusalem unë jom kthy prapë në Kosovë për pesë muj për me ligjëru në AUK [*American University of Kosova*]. Si pjesë të, ligjërimin gjithmonë kom pasë dëshirë me mbajt jo pse jom e mirë n'atë punë, po pse kom mendu që mund, osht' nifarë kontributi që muj, mundem me kthy në Kosovë. Qoftë për shkak t'akumulimit t'përvojës, po edhe një memorie t'cilën unë po kom frikë që zbehët në Kosovë.

Domethonë nuk ka, nuk kemi referencë për t'kalumën. Nuk kemi njerëz shumë që flasin për t'kalumën. T'gjithë e kemi shumë vëhtirë me, me, me vnu n'kontekst t'zhvillimeve t'kalumën tonë t'cilën e kemi përjetu si gjeneratë. Edhe shpeshherë, po t'njejtën kohë mësimdhanja mu po m'ndihmon edhe me ecë tutje. Se po shoh që gjenerata e re pak ka referencë për t'kalumën. Ndoshta edhe ajo p'i, p'i mu, p'e mundëson me ecë tutje t'pa ngarkum, pa shumë kontekst për zhvillimet. Ndoshta me njohuri po, po, a din me njohuri kisha pasë qef me pas ma shumë, po pa ngarkesën se duhët me ba gjana për shkak të, për hir të ni ideje ose për hir t'ni idealizmi. Edhe po provoj që përmes... m'i inkuraju që me, me, me pa rrethin përreth tyre.

**Aurela Kadriu:** Çfarë klase keni ligjëru në AUK?

**Garentina Kraja:** I kom, këtë semestër i kom ligjëru dy, *Faith and Globalization*, Feja dhe Globalizimi edhe Politikat e Shteteve në Zhvillim. Dyjat tema t'cilat m'interesojnë edhe prej aspektit profesional. Po provoj, po, kom provu m'i inspiru studentat edhe m'i mësu për aq sa kom mujt me, kryesisht tu ju apelu me shiku rrethin përreth. Rrethin e tyre. Me, me, me provu m'i interesu çka ndodhë përtej Prishtinës. Unë besoj sot, sikur që kom besu në '98-tën që njana prej sfidave kryesore tona mbetët ni shkëputje e qytetit edhe pjesës rurale të Kosovës. Na nuk e njohim vendin tonë shumë mirë. Nuk e kemi... ni pjesë e shoqërisë tonë ka ecë shumë përpara. Ni pjesë tjetër ka mbetë shumë mbrapa, edhe kom frikë që çfarëdo, çfarëdo... zhvillimi jonë ka m'u mvarë prej kësaj, prej këti, prej kësaj.... Jo ka m'u mvarë, po ka me qenë i pengum ndoshta prej kësaj shkëputje t'këtyre dy, dy niveleve t'shoqërisë tonë.

**Aurela Kadriu:** Nëse nuk ki diçka tjetër me shtu, unë e kisha mbyllë.



**Garentina Kraja:** Qikaq.

**Aurela Kadriu:** Falemnderit shumë.

**Garentina Kraja:** Falemnderit juve.